

REZOLUTË E ADOPTUAR NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

[mbi raportin e Komitetit Ad Hoc të Sesionit të Posaçëm të Njëzetë e Tretë të Asamblesë së Përgjithshme(A/S-23/10/Rev.1)]

S-23/3. Veprime dhe nisma të tjera në zbatim të Deklaratës së Beijing dhe Platforma e Veprimit

Asambleja e Përgjithshme

Adopton veprimet dhe iniciativat e mëtejshme në zbatim të Deklaratës së Beijing¹ dhe Platformën e Veprimit² që është aneks i kësaj rezolute.

Takimi i 10të plenar

10 qershor 2000

Aneks

Veprime dhe nisma të mëtejshme në zbatim të Deklaratës së Beijing dhe Platforma e Veprimit

I. Hyrje

1. Qeveritë që u mblodhën në seancën e veçantë të Asamblesë së Përgjithshme kanë riafirmuar angazhimin e tyre për synimet dhe objektivat e Deklaratës së Beijing dhe Platformën e Veprimit të adoptuar në Konferencën e Katërt Botërore në 1995, ashtu si është në raportin e Konferencës. Deklarata e Beijing dhe Platforma për Veprim parashtrojnë synimet për barazi gjinore, zhvillim dhe paqe dhe përbëjnë një program për aftësimin e grave. Qeveritë rishikuan dhe vlerësuan përparimin dhe identifikuan pengesat dhe sfidat aktuale në zbatimin e Platformës së Veprimit. Ato njohën zyrtarisht se synimet e parashtuara dhe angazhimet e bëra në Platformën e Veprimit nuk janë përmbushur dhe zbatuar tërësisht, dhe ranë dakord për veprime të mëtejshme dhe nisma në nivele lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për të përshpejtuar zbatimin e Platformës së Veprimit dhe për të garantuar se angazhimet për barazi gjinore, zhvillim dhe paqe përmbushen plotësisht.

2. Platforma e Beijing për Veprim identifikoi dymbëdhjetë fusha kritike shqetësimi që i vënë përparësi veprimit në lidhje me përparimin dhe fuqizimin e pozitës së grave. Komisioni për Statusin e Grave ka rishikuar përparimin e bërë në secilën nga këto dymbëdhjetë fusha dhe qysh prej 1996 ka adoptuar konkluzionet dhe rekomandimet për zbatim të përshpejtuar. Platforma e

¹ *Raporti i Katërt i Konferencës për Gratë, Beijing, 4-15 shtator 1995* (Publikim i Kombeve të Bashkuara, Shitjet Nr. E.96.IV.13), kap. I, rezolutë 1, aneksi I.

² *Ibid.*, aneksi II.

Veprimi, së bashku me këto konkluzione dhe rekomandime, krijojnë bazën për përparim të mëtejshëm drejt arritjes së barazisë gjinore, zhvillimit dhe paqes në shekullin e njëzetë e një.

3. Objektivi i Platformës për Veprimin, që është në përputhje të plotë me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe ligjit ndërkombëtar, është fuqizimi i të gjitha grave. Realizimi i plotë i të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të të gjitha grave është themelor për fuqizimin e grave. Ndërsa duhet të mbajmë parasysh kuptimin e veçantive kombëtare dhe rajonale dhe konteksteve të ndryshme historike, kulturore, dhe fetare, është detyrë e Shteteve pavarësisht sistemeve të tyre politike, ekonomike dhe kulturore, për të çuar përpara dhe ruajtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Zbatimi i Platformës për Veprimin, përmes ligjeve kombëtare dhe strategjive, politikave, dhe programeve të zhvillimit, është përgjegjësi sovranë e çdo Shteti, në përputhje me të gjitha të drejtat njerëzore dhe liritë themelore, dhe në respekt të plotë për vlerat e ndryshme fetare dhe etike, kontekstet kulturore dhe bindjet filozofike të individëve dhe komuniteteve të tyre duhet të kontribuojnë për gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut nga gratë dhe për arritjen e barazisë, zhvillimit dhe paqes.

4. Platforma për Veprimin thekson se gratë ndajnë shqetësime që mund të trajtohen vetëm duke punuar së bashku dhe në partneritet me burrat drejt një qëllimi të përbashkët të barazisë gjinore në mbarë botën. Platforma respekton dhe vlerëson ndryshimet e situatave dhe kushteve të grave dhe njih zërtarisht se disa gra përballen me pengesa të veçanta në rrugën drejt fuqizimit të tyre.

5. Platforma për Veprimin njih zërtarisht se gratë hasin pengesa në rrugën drejt barazisë së plotë dhe përparimit për faktorë të tillë si raca, mosha, gjuha, etnia, kultura, feja ose paafësia fizike, për shkak se ato janë indigjene ose për ndonjë status tjetër. Shumë gra hasin pengesa specifike që lidhen me statusin e familjes së tyre, në veçanti si prindër të vetëm, dhe për statusin e tyre social-ekonomik, duke përfshirë kushtet e tyre të jetesës në zona fshatare, të izoluara dhe të varfëra. Pengesa shtesë ekzistojnë për gratë refugjate, gratë e zhvendosura duke përfshirë gratë e zhvendosura brenda vendit, si dhe për gratë imigrante dhe migrante, duke përfshirë punëtorët migrante. Shumë gra ndikohen veçanërisht nga fatkeqësitë mjedisore, sëmundjes serioze dhe infektive dhe forma të tjera të dhunës kundër grave.

II. Arritjet dhe pengesat gjatë zbatimit të dymbëdhjetë fushave kritike të Platformës për Veprimin të Beijingit.

6. Vlerësimi i arritjeve dhe pengesave duhet të bëhet në lidhje me angazhimet e marra në Platformën për Veprimin të Beijingit dhe të dymbëdhjetë fushave të veta kritike. Kjo bëhet duke parë veprimet e marra dhe rezultatet e arritura, si tregohet nga raportet kombëtare, dhe nga raportet e Sekretarit të Përgjithshëm, rezultatet, përfundimet dhe marrëveshjet e pesë takimeve rajonale të mbajtura për përgatitjen e seancës së pestë të Asamblesë së Përgjithshme, dhe burimet e tjera përkatëse. Këto vlerësime tregojnë se, megjithë zhvillimet pozitive, ka ende pengesa dhe se duhet të vazhdojë zbatimi për arritjen e qëllimeve dhe të angazhimeve të marra në Beijing. Përmbledhja e arritjeve dhe e pengesave të reja ose të vjetra mund të përbëjë një kornizë globale për identifikimin e veprimeve dhe nismave të mëtejshme drejt kapërcimit të pengesave dhe drejt arritjes së zbatimit të plotë dhe të përshpejtuar të Platformës së Veprimin në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat.

A. Gratë dhe varfëria

7. *Arritjet.* Progres i dukshëm është arritur në rritjen e kuptimit të dimensioneve gjinore të varfërisë dhe për pranimin që barazia gjinore është një nga faktorët më rëndësi të veçantë për çrrënjosjen e varfërisë veçanërisht në lidhje me feminizimin e varfërisë. Qeveritë në bashkëpunim me organizatat jo-qeveritare, kanë bërë përpjekje për të integruar një perspektivë gjinore në politikat dhe programet për çrrënjosjen e varfërisë. Institucionet financiare, shumëanëshe, ndërkombëtare dhe rajonale po i kushtojnë vëmendje më të madhe përfshirjes së perspektivës gjinore në politikat e tyre. Është bërë përparim duke ndjekur një rrugë dydrejtimshe, njëri, nxitja e punësimit dhe e aktiviteteve fitimprurëse dhe tjetri qasja tek shërbimet bazë sociale, ku përfshihen arsimimi dhe kujdesi shëndetësor. Mikrokrediti dhe instrumentet financiare për gratë shfaqen si strategji të suksesshme për fuqizimin ekonomik dhe kanë zgjeruar mundësitë ekonomike të disa grave që jetojnë në varfëri, në veçanti në zonat fshatare. Zhvillimi i politikave ka marrë në konsideratë nevojat e veçanta të familjeve që kryesohen nga gratë. Studimi ka rritur të kuptuarit e ndikimit të varfërisë mbi gratë dhe burrat dhe janë krijuar instrumente për të ndihmuar këtë vlerësim.

8. *Pengesat.* Shumë faktorë kanë kontribuar për rritjen e pabarazisë ekonomike mes grave dhe burrave, duke përfshirë pabarazinë e të ardhurave, papunësinë dhe thellimin e niveleve të varfërisë të grupeve të dobëta dhe të veçuara. Barra e borxheve, shpenzimet e mëdha ushtarake, që janë në mospërputhje me kërkesat e sigurisë kombëtare, masat e njëanshme detyruese që dallojnë nga ligji ndërkombëtar dhe Karta e Kombeve të Bashkuara, konflikti i armatosur, pushtimi i huaj, terrorizmi, nivelet e ulëta të ndihmës zyrtare për zhvillim dhe mospëmbushja e angazhimit për të arritur objektivin e ndërmarrë, ndërkombëtarisht, të 0.7 për qind të produktit vendor bruto, të vendeve të zhvilluar për ndihmën zyrtare për zhvillim dhe 0.15 deri në 0.2 për qind të vendeve më pak të zhvilluara, si dhe mos përdorimi efikas i burimeve, ndër të tjera, mund të pengojnë ndër të tjera përpjekjet kombëtare për të luftuar varfërinë.

Përveç kësaj, pabarazitë gjinore dhe ato të ndarjes së pushtetit ekonomik, shpërndarja e pabarabartë e punës së pashpërblyer të grave dhe të burrave, mungesa e mbështetjes teknologjike dhe financiare për ndërmarrjet e grave, qasja e pabarabartë dhe kontrolli mbi kapitalin, veçanërisht mbi truallin dhe kreditin dhe qasja në tregun e punës, si dhe të gjitha praktikatat tradicionale dhe zakonore të dëmshme, kanë kufizuar fuqizimin ekonomik të grave dhe kanë thelluar feminizimin e varfërisë. Ristrukturimi themelor ekonomik që kanë provuar vendet me ekonomi në tranzicion ka çuar në mungesën e burimeve për programet e çrrënjosjes së varfërisë me synim fuqizimin e grave.

B. Arsimimi dhe trajnimi

9. *Arritjet.* Është rritur ndërgjegjësimi se arsimimi është një nga mjetet më të vlefshme për arritjen e barazisë gjinore dhe për fuqizimin e grave. Është arritur përparim në arsimimin e grave dhe të vajzave dhe në trajnimin në të gjitha nivelet veçanërisht në vendet ku ka angazhim të mjaftueshëm politik dhe burime të dedikuara. Janë marrë masa në të gjitha rajonet për të filluar sisteme alternative arsimimi dhe trajnimi për të arritur gratë dhe vajzat në komunitetet indigjene dhe të gjitha grupet e tjera të pafavorizuara dhe të veçuara për t'i inkurajuar ato që të ndjekin të gjitha fushat e studimit, në veçanti fushat jo tradicionale të studimit, dhe për të larguar anshmëritë gjinore për arsimimin dhe trajnimin.

10. *Pengesat*. Në disa vende, përpjekjet për çrrënjosjen e analfabetizmit dhe për rritjen e kulturës së grave dhe të vajzave, për rritjen e qasjes së tyre në të gjitha nivelet dhe llojet e arsimit janë kufizuar nga mungesa e burimeve, vullneti i pamjaftueshëm politik dhe mosangazhimi për të përmirësuar infrastrukturën arsimore dhe kryerjen e reformave arsimore; diskriminimi dhe anshmëria gjinore, përfshirë edhe në trajnimin e mësuesve; stereotipet gjinore që lidhen me profesionet, institucionet për edukimin e mëtejshëm dhe komunitetet; mungesa e njësive për kujdesin e fëmijëve; përdorimi i vazhdueshëm i stereotipeve gjinore në materialet arsimore; dhe vëmendja e pamjaftueshme kushtuar lidhjes ndërmjet regjistrimit të grave në institucione të arsimit të lartë dhe dinamikave të tregut të punës. Vendndodhja e largët e disa komuniteteve, dhe në disa raste, pagat dhe përfitimet e papërshtatshme e bëjnë të vështirë tërheqjen dhe mbajtjen e arsimitarëve profesionistë dhe mund të çojë në një nivel të ulët të arsimit. Përveç kësaj, në një numër vendesh, pengesat ekonomike, sociale dhe infrastrukturore, si dhe praktikat tradicionale diskriminuese, kanë kontribuar numrin e vogël të vajzave që regjistrohen dhe vazhdojnë shkollën.

Ka pasur pak përparim në lidhje me çrrënjosjen e analfabetizmit në disa vende të zhvilluara, çka ka thelluar pabarazinë në nivelet ekonomike, sociale dhe politike. Në disa nga këto vende, krijimi dhe zbatimi i politikave strukturore të papërshtatshme ka pasur një ndikim veçanërisht të keq mbi sektorin arsimor që kur ato sollën investime në rënie në infrastrukturën arsimore.

C. Gratë dhe shëndeti

11. *Arritjet*. Janë zbatuar programe për ndërgjegjësimin e politikë- bërësve dhe planifikuesve për nevojën e programeve shëndetësore për mbulimin e të gjithë aspekteve të shëndetit të grave gjatë tërë ciklit të jetës, të tyre, çka ka kontribuar në rritjen e jetëgjatësisë në shumë vende. Ka: vëmendje më të madhe për vdekshmërinë e lartë amtare ndër gratë dhe vajzat si rezultat i malaries, tuberkulozit, sëmundjeve nga uji, sëmundjeve infektive dhe diarresë dhe kequshqyerjes; vëmendje të lartë për shëndetin seksual dhe riprodhues dhe për të drejtat riprodhuese të grave si jepet në paragrafët 94 dhe 95 të Platformës për Veprim, si dhe në disa vende është vënë theks i veçantë për zbatimin e paragrafit

96 të Platformës për Veprim; dijet dhe përdorimi më i madh i planifikimit familjar dhe metodave kontraceptive si dhe ndërgjegjësimi më i madh ndër burrat për përgjegjësinë e tyre në planifikimin e familjes, metodat kontraceptive dhe përdorimin e tyre; vëmendje e rritur për infeksionet seksualisht të transmetueshme, duke përfshirë virusin e pamjaftueshmërisë imunitare të njeriut/sindromin e fituar të pamjaftueshmërisë imunitare

(HIV/AIDS) ndër gratë dhe vajzat, dhe metodat për mbrojtjen kundër këtyre infeksioneve; vëmendje më e lartë ndaj ushqyerjes me gji, ushqimit, shëndetit të nënës dhe të fëmijës; futja e perspektivës gjinore në shëndetësi dhe në aktivitetet edukative dhe fizike të lidhura me shëndetin, programet për parandalimin dhe riaftësimin në lidhje me abuzimin me substance, ku përfshihen duhani, drogat, dhe alkooli;

Vëmendje më e lartë për shëndetin mendor të grave, kushtet shëndetësore në punë, mjedisin, dhe njohja e nevojave të veçanta shëndetësore të grave të moshuara. Në sesionin e vet të njëzetë e një, të mbajtur në Neë York nga 30 qershori deri në 2 korrik, 1999, Asambleja e Përgjithshme rishikoi arritjet dhe adoptoi veprimet kryesore³ në fushën e shëndetit të grave për

³ Shih rezolutën S-21/2, aneksi.

zbatimin e mëtejshëm të Programit të Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin⁴.

12. Pengesat. Hendeku ndërmjet dhe brenda vendeve të pasura dhe të varfëra në lidhje me vdekshmërinë dhe sëmundshmërinë foshnjore dhe amtare si dhe në lidhje me masat që trajtojnë shëndetin e grave dhe vajzave, duke marrë në konsideratë dobësinë e tyre në lidhje me infeksionet seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS dhe probleme të shëndetit seksual dhe riprodhues, së bashku me sëmundjet endemike, infektive dhe të transmetueshme, si malaria, tuberkulozi, sëmundjet e diarresë dhe të ujit, dhe sëmundjet kronike jo të transmetueshme, mbeten të papranueshme. Në disa vende, sëmundje të tilla endemike, infektive, dhe të transmetueshme, vazhdojnë të marrin jetë grash dhe vajzash. Në vende të tjera, sëmundjet e patransmetueshme, të tilla si ato kardiopulmonare, hipertensioni dhe sëmundjet degjeneruese, mbeten ndër shkaqet madhore të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë së grave. Pavarësisht progresit të bërë, në disa vende vdekshmëria dhe sëmundshmëria e grave mbetet jashtëzakonisht e lartë. Investimet në kujdesin obstetrik mbeten të pamjaftueshme në shumë vende. Mungesa e një trajtimi tërësor të çështjeve të shëndetit dhe kujdesit shëndetësor për gratë dhe vajzat që duhej bazuar në të drejtën e grave për gëzimin e standardit më të lartë të shëndetit fizik dhe mendor gjatë tërë ciklit të jetës së tyre ka penguar përparimin. Disa gra vazhdojnë të ndeshin pengesa në të drejtën e tyre për të gëzuar standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit fizik dhe mendor. Fokusimi i sistemeve të kujdesit shëndetësor në trajtimin e sëmundjeve jo vetëm që nuk arrin shëndetin optimal por edhe pengon trajtimin tërësor të problemit. Në disa vende, i kushtohet vëmendje e pamjaftueshme, rolit të përcaktuesve socialë dhe ekonomik të shëndetit. Mungesa e qasjes tek uji i pijshëm, ushqimit të pamjaftueshëm, dhe higjienës, mungesa e kërkimeve dhe teknologjisë shëndetësore gjinore, dhe ndjeshmëria e ulët gjinore në dhënien e informacionit shëndetësor, kujdesit dhe shërbimeve shëndetësore duke përfshirë ato që lidhen me mjedisin dhe rreziqet shëndetësore nga profesioni, ndikojnë gratë në vendet në zhvillim dhe ato të zhvilluara. Varfëria dhe mungesa e zhvillimit vazhdojnë të ndikojnë kapacitetin e shumë vendeve në zhvillim që të japin dhe zgjerojnë cilësinë e kujdesit shëndetësor. Mangësia në burimet financiare dhe njerëzore, në veçanti në vendet në zhvillim, si dhe ristrukturimi i sektorit shëndetësor dhe/ose tendenca në rritje për privatizimin e sistemeve të kujdesit shëndetësor në disa raste, ka rezultuar në cilësinë e dobët, shërbime të pakta dhe të pamjaftueshme të kujdesit shëndetësor, dhe ka çuar në më pak vëmendje për shëndetin e grupeve më të dobëta të grave. Këto pengesa si dhe marrëdhënia e pabarabartë ndërmjet burrave dhe grave, në të cilin gratë shpesh nuk kanë pushtetin që të këmbëngulin për praktika seksuale të sigurta dhe të përgjegjshme, dhe mungesa e komunikimit dhe të kuptuarit mes nevojave shëndetësore të burrave dhe grave, ndër të tjera, rrezikon shëndetin e grave, veçanërisht duke i vënë ato më në rrezik ndaj infeksioneve seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS, dhe ndikon mbi qasjen e grave ndaj kujdesit shëndetësor dhe arsimimit, veçanërisht në lidhje me parandalimin. Adoleshentët, veçanërisht adoleshentet, vazhdojnë të mos kenë qasje në informacionin shëndetësor seksual dhe riprodhues, arsimimin dhe shërbimet. Gratë që marrin kujdes shëndetësor shpesh nuk trajtohen me respekt dhe as me fshehtësi dhe konfidencialitet dhe nuk marrin informacionin e plotë për mundësitë dhe shërbimet që ekzistojnë. Në disa raste, shërbimet dhe punonjësit shëndetësor ende nuk respektojnë të drejtat e njeriut dhe standardet etike, profesionale, dhe gjinore gjatë dhënies së

⁴ Raporti i Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin, Kairo, 5-13 shtator 1994 (Publikimi i Kombeve të Bashkuara, Shitjet Nr. E.95.XIII.18), kap. I, rezolutë 1, aneksi.

shërbimeve për gratë, dhe as nuk garantojnë aprovimin e përgjegjshëm, vullnetar dhe të informuar. Vazhdon të ketë një mungesë informacioni për ekzistencën dhe qasjen në shërbimet e përshtatshme, të përballueshme, të kujdesit parësor shëndetësor të cilësisë së lartë, duke përfshirë shërbimin e kujdesit seksual dhe riprodhues, vëmendjen e pamjaftueshme për shëndetin amtar dhe emergjencën obstetrike si dhe mungesë të parandalimit, depistimit, dhe trajtimit të kancerit të gjirit dhe atij cervical, kancerit të ovareve dhe osteoporozës. Testimi dhe krijimi i kontraktivëve mashkullorë është i pamjaftueshëm. Ndërsa janë marrë disa masa në disa vende, veprimet e parashtruara në paragrafët 106 (j) dhe (k) të Platformës për Veprim në lidhje me ndikimin tek shëndeti i abortit të pasigurt dhe nevojën për të pakësuar numrin e aborteve nuk janë zbatuar plotësisht. Incidenca në rritje e duhanpirëseve, ka rritur rrezikun e tyre për kancer dhe sëmundje të tjera serioze, si dhe rreziqe të tjera specifike gjinore nga duhani dhe tymi i duhanit në mjedis.

D. Dhuna kundër Grave

13. *Arritjet.* Pranohet gjërësisht se dhuna kundër grave dhe vajzave, qoftë kjo në jetën publike ose private, është një çështje e të drejtave të njeriut. Pranohet se dhuna kundër grave, kur kryhet ose lejohet nga Shteti ose agjentët e tij, përbën një shkelje të të drejtave të njeriut. Pranohet gjithashtu se Shtetet kanë detyrim që të ushtrojnë kujdesin e duhur për të parandaluar, hetuar dhe ndëshkuar aktet e dhunës, qoftë kur këto kryhen nga Shteti ose nga persona privatë, dhe të ofrojnë mbrojtje për viktimat. Veç të tjerash, legjislacioni i përmirësuar, politikat dhe programet kanë sjellë një rritje të ndërgjegjësimit dhe të angazhimit për të parandaluar dhe luftuar dhunën kundër grave dhe vajzave, duke përfshirë dhunën në shtëpi, çka shkel dhe dëmton ose vret gëzimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore. Qeveritë kanë nisur reforma politikash dhe mekanizma, të tillë si, komitetet disa-departmentëshe, udhëzues dhe protokolle, programe kombëtare, shumëdimensionëshe dhe të koordinuara për të trajtuar dhunën. Disa qeveri kanë futur gjithashtu ose kanë reformuar ligjet për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga të gjitha format e dhunës dhe ligjet për të ndjekur penalisht autorët.

Ka një pranim më të madh në të gjitha nivelet se të gjitha format e dhunës kundër grave ndikojnë seriozisht shëndetin e tyre. Punonjësit e kujdesit shëndetësor konsiderohet të kenë një rol domethënës në trajtimin e kësaj çështjeje. Ka pasur përparim në dhënien e shërbimeve për gratë dhe fëmijët e abuzuar, duke përfshirë shërbimet ligjore, strehëzat, shërbimet e posaçme shëndetësore dhe këshillimi, linjat telefonike dhe njësitë policore me trajnim të specializuar. Ka përparim në arsimimin i personelit të zbatimit të ligjit, anëtarëve të gjyqësorit, punonjësve të kujdesit shëndetësor, dhe punonjësve të shërbimeve sociale. Janë krijuar materiale edukative për gratë dhe fushata për ndërgjegjësimin publik si dhe janë bërë kërkime për shkaqet e dhunës. Janë shtuar kërkimet dhe studimet e specializuara për rolet gjinore, në veçanti të burrave dhe të djemve dhe të të gjitha formave të dhunës kundër grave si dhe për situatat dhe ndikimin mbi fëmijët që rriten në familje ku ka dhunë.

Është arritur bashkëpunim i suksesshëm midis organizatave qeveritare dhe jo-qeveritare në fushën e parandalimit të dhunës kundër grave. Mbështetja aktive e shoqërisë civile, në veçanti e organizatave të grave dhe organizatave jo-qeveritare, ka pasur rol të rëndësishëm, ndër të tjera, për fushatat ndërgjegjësuese dhe për dhënien e shërbimeve mbështetëse për gratë viktime të dhunës. Përpjekjet për çrënjjosjen e praktikave të dëmshme tradicionale, ku përfshihet gjymtimi femëror gjinital, që është formë e dhunës kundër grave, ka marrë mbështetje politike

kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Shumë qeveri kanë futur programe edukative si dhe masa legislative që kriminalizojnë këto praktika.

Përveç kësaj, kjo mbështetje përfshin emërimin e një Ambasadori të Posaçëm për Zhdukjen e Gjymtimit Femëror Gjenital nga Fondi i Popullsisë së Kombeve të Bashkuara.

14. *Pengesat*. Gratë vazhdojnë të jenë viktimat të formave të ndryshme të dhunës. Kuptimi i papërshtatshëm i shkaqeve të të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe vajzave pengon përpjekjet për eliminimin e dhunës kundër grave dhe vajzave. Ka një mungesë të programeve gjithëpërfshirëse që trajtojnë autorët, përfshirë programet, kur është e përshtatshme, që do t'u mundësonte atyre t'i zgjidhin problemet pa dhunë. Të dhënat e papërshtatshme për dhunën pengojnë edhe më shumë politikëbërjen e analizën e informuar.

Qëndrimet social kulturore që janë pabarazitë diskriminuese dhe ekonomike përforcojnë vendin e nënshtruar të grave të shoqëri. Kjo bën që gratë dhe vajzat të jenë të ekspozuara ndaj shumë formash dhune, si dhuna fizike, seksuale dhe psikologjike, që ngjasin në familje, përfshirë rrahjen, abuzimin seksual të vajzave të vogla në shtëpi, dhuna që lidhet me pajën, përdhunimi martesor, gjymtimi gjenital femëror, dhe praktika të tjera tradicionale të grave, dhuna jobashkëshortore dhe dhuna që lidhet me shfrytëzimin. Në shumë vende, trajtimi i koordinuar, shumëdimensional në përgjigje të dhunës, që përfshin sistemin shëndetësor, vendin e punës, mjetet e informimit, sistemin e edukimit, si dhe atë të drejtësisë, mbetet ende i kufizuar. Dhuna në familje, duke përfshirë dhunën seksuale në martesë, trajtohet akoma si çështje private në disa vende. Ende ka ndërjegjësim të pamjaftueshëm për pasojat e dhunës në familje, në lidhje me parandalimin e saj dhe të drejtat e viktimave. Megjithatë përmirësimet e masave ligjore dhe legislative, veçanërisht në fushën e drejtësisë penale, për të eliminuar format e ndryshme të dhunës kundër grave dhe fëmijëve, përfshirë dhunën në familje dhe pornografinë e fëmijëve, janë shumë të dobëta në shumë vende. Strategjitë parandaluese mbeten të fragmentuara dhe reaktive dhe mungojnë programet për këto çështje.

Gjithashtu vërehet, se në disa vende, problemet burojnë nga përdorimi i informacionit të ri dhe i teknologjisë së komunikimit për trafikimin e grave dhe të fëmijëve dhe për qëllime të të gjitha formave të shfrytëzimit ekonomik dhe seksual.

E. Gratë dhe konflikti i armatosur

15. *Arritjet*. Ka një njohje më të gjerë se ndikimi shkatërrimtar i konfliktit të armatosur është i ndryshëm mbi gratë nga burrat dhe se është e rëndësishme të ketë një trajtim me ndjeshmëri gjinore në zbatimin e ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe të ligjit ndërkombëtar humanitar. Janë marrë hapa në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare për të trajtuar abuzimet kundër grave, përfshirë një vëmendje më të madhe për t'i dhënë fund mosndëshkimit për krimet kundër grave në situata konfliktesh të armatosura.

Puna e Tribunalëve Ndërkombëtarë për Ish Jugosllavinë⁵ dhe Ruandën⁶ ka qënë një kontribut i rëndësishëm për të trajtuar dhunën kundër grave në kontekstin e konfliktit të armatosur.

⁵ Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje Serioze të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryer në Territorin e Ish Jugosllavisë që prej 1991.

⁶ Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të tjera të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar në Territorin e Ruandës dhe ndaj Shtetasve Ruandianë përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të tjera të kryera në Territorin e Shteteve Fqinjë nga 1 janari dhe 31 dhjetori 1994.

⁷ A/CONF.183/9.

Gjithashtu, me rëndësi historike ka qënë adoptimi i Statutit të Romës i Gjykatës Kriminale Ndërkombëtare⁷, çka parasheh se përdhunimi, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e detyruar, sterilizimi i detyruar dhe forma të tjera të dhunës seksuale janë krime lufte kur kryhen në kontekstin e konfliktit të armatosur dhe në rrethana të caktuara, krime kundër njerëzimit. Po pranohet gjithnjë e më shumë kontributi i grave në fushën e ndërtimit të paqes, arritjes së paqes dhe zgjidhjes së konfliktit. Është prezantuar arsimimi dhe trajnimi për zgjidhjen e konfliktit të padhunshëm. Ka pasur përparim për shpërndarjen dhe zbatimin e udhëzimeve për mbrojtjen e grave refugjate, dhe për trajtimin e nevojave të grave të zhvendosura. Persekutimi me bazë gjinore është pranuar si bazë për statusin e refugjatëve në disa vende. Është pranuar nga Qeveritë, komuniteti dhe organizatat ndërkombëtare, në veçanti Kombet e Bashkuara, që gratë dhe burrat i përfshijnë emergjencat humanitare ndryshe nga njëri tjetri, dhe ekziston nevoja për një mbështetje tërësore për refugjatët dhe gratë e zhvendosura, përfshirë ato që kanë vuajtur të gjitha format e abuzimit, përfshirë abuzimin me bazë gjinore, për të garantuar qasje të barabartë në ushqimin dhe ushqyerjen e përshtatshme dhe të duhur, ujë e pastër, higjienizimin e sigurt, strehën, arsimin, shërbimet sociale dhe shëndetësore, dhe kujdesin amtar. Ka një njohje më të madhe të nevojës për të integruar perspektivën gjinore në planifikimin, hartimin dhe zbatimin e ndihmës humanitare dhe në dhënien e burimeve të përshtatshme.

Agjencitë e ndihmës humanitare dhe shoqëria civile, duke përfshirë organizatat jo-qeveritare, kanë luajtur një rol gjithnjë në rritje në dhënien e ndihmës humanitare, si dhe në hartimin, kur është e mundur, dhe zbatimin e programeve për të trajtuar nevojat e grave dhe të vajzave, duke përfshirë gratë dhe vajzat refugjate dhe të zhvendosura në emergjencat humanitare, dhe në situata konflikti dhe pas-konflikti.

16. *Pengesat.* Paqja është pazgjidhshmërisht e lidhur me barazinë midis grave dhe burrave dhe zhvillimin. Konfliktet e armatosur dhe konfliktet e llojeve të tjerë, luftrat aggressive, pushtimi i huaj, dominimi i të huajve të tjerë, si dhe terrorizmi, vazhdojnë të shkaktojnë pengesa serioze për përparimin e grave. Shënjestrimi i civilëve, përfshirë gratë dhe fëmijët, zhvendosja e njerëzve, rekrutimi i fëmijëve ushtarë në shkelje të ligjit kombëtar dhe ndërkombëtar, nga Shteti dhe/ose jo-Shteti, që ndodh në konfliktet e armatosur, kanë pasur një ndikim veçanërisht negativ mbi barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut të grave. Konflikti i armatosur krijon ose thellon numrin e madh të familjeve që drejtohen nga femra, të cilat në shumë raste jetojnë në varfëri. Përfaqësimi në numra të paktë, në të gjitha nivelet, i grave në vendimmarrje, të tilla si të dërguara të posaçme ose përfaqësuese të posaçme të Sekretarit të Përgjithshëm, në ruajtjen e paqes, ndërtimin e paqes, pajtimin pas konfliktit dhe rindërtimin, si dhe mungesa e ndërjegjësimit gjinor në këto fusha, përfaqësojnë pengesa serioze.

Ka pasur një dështim për të dhënë burime të mjaftueshme, për të shpërndarë si duhet burimet, dhe për të trajtuar nevojat e numrit në rritje të refugjatëve, që janë më shumë gra dhe fëmijë, veçanërisht në vendet në zhvillim që presin numër të madh refugjatësh; ndihma ndërkombëtare nuk ka qënë në një hap me numrin në rritje të refugjatëve.

Numri në rritje i personave të zhvendosur brenda vendit, në veçanti gra dhe fëmijë, vazhdon të përfaqësojë një barrë të dyfishtë për vendet e ndikuara dhe burimet e tyre financiare. Problem

mbetet trajnimi i papërshtatshëm i personelit që merret me nevojat e grave në situata konflikti të armatosur ose të refugjatëve, të tillë si mangësi programesh të posaçme që trajtojnë shërimin e grave, nga trauma dhe trajnimi i papërshtatshëm i shprehive të personelit.

17. Shpenzimet e skajshme ushtarake, përfshirë shpenzimet globale ushtarake, tregtimi i armëve dhe investimi për prodhimin e armëve, duke marrë në konsideratë, kërkesat për sigurinë kombëtare, çojnë në pakësimin e fondeve për zhvillim social dhe ekonomik, në veçanti atyre për përparimin e grave. Në disa vende, sanksionet ekonomike kanë patur ndikime sociale dhe humanitare mbi popullsinë civile, në veçanti gratë dhe fëmijët.

18. Në disa vende, përparimi i grave është penguar nga masa të njëanshme që nuk pajtohen me ligjin ndërkombëtar dhe Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe krijojnë pengesa për marrëdhëniet tregtare ndërmjet Shteteve, pengojnë realizimin e plotë të zhvillimit social dhe ekonomik dhe rrezikojnë mirëqënien e popullsisë në vendet e ndikuara, me pasoja kryesisht tek gratë dhe fëmijët.

19. Në situatat e konfliktit të armatosur, ka shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut të grave, që janë shkelje të parimeve themelore të ligjit të të drejtave ndërkombëtare dhe ligjit ndërkombëtar humanitar. Ka pasur një rritje në të gjitha format e dhunës kundër grave, përfshirë skllavërinë seksuale, përdhunimin, përdhunimin sistematik, abuzimin seksual dhe shtatzënitë e detyruara, në situata konflikti të armatosur. Zhvendosja e kombinuar me humbjen e shtëpisë dhe të pasurisë, varfërinë, shpërbërjen e familjes, dhe ndarjen dhe pasoja të tjera të konfliktit të armatosur ndikojnë seriozisht mbi popullsinë, veçanërisht mbi gratë dhe fëmijët. Edhe vajzat rekrutohen në shkelje të ligjit ndërkombëtar, në situata konflikti të armatosur, përfshirë luftëtarët, skllavërit seksual ose punonjësit e shërbimeve shtëpiake.

F. Gratë dhe Ekonomia

20. *Arritjet.* Ka një pjesëmarrje në rritje të grave në tregun e punës dhe rritje të pavarësisë ekonomike si pasojë e kësaj. Disa qeveri kanë marrë një sërë masash që trajtojnë të drejtat ekonomike dhe sociale të grave, qasjen e barabartë dhe kontrollin e burimeve ekonomike dhe barazinë në punësim. Masa të tjera përfshijnë ratifikimin e konventave ndërkombëtare të punës si dhe krijimin dhe forcimin e legjislacionit për t'i bërë ato të krahasueshme me këto konventa. Ka një ndërgjegjësim në rritje për nevojën për të balancuar punësimin dhe përgjegjësitë në familje dhe të efektit pozitiv të këtyre masave si leja pas lindjes së fëmijës për nënën dhe babanë, dhe shërimbet e kujdesit të familjes dhe përfitimet. Disa qeveri kanë hartuar dispozita për të trajtuar sjelljet diskriminuese dhe abuzive në vendin e punës dhe për parandalimin e kushteve të pashëndetshme të punës, dhe kanë ngritur mekanizma financimi për avancimin e rolit të grave në biznes, edukim dhe trajnim, përfshirë shprehitë shkencore dhe teknike dhe vendimmarrjen. Janë kryer studime për pengesat për fuqizimin ekonomik të grave, përfshirë marrëdhënien mes punës së paguar dhe të papaguar, dhe po krijohen instrumente për të ndihmuar këtë vlerësim.

21. *Pengesat.* Rëndësia e perspektivës gjinore në zhvillimin e politikës makroekonomike mbetet ende e pakuptuar nga të gjithë. Shumë gra punojnë akoma në fshat dhe në ekonominë jozyrtare si prodhuese të ushqimi, dhe në sektorët e shërbimit me nivele të ulëta të ardhurash

dhe pak sigurim në punë dhe shoqëror. Shumë gra me shprehi dhe përvojë të krahasuesme hasin një hendek në paga për arsye gjinore, dhe mbeten mbrapa burrave në të ardhura dhe karrierë në sektorin zyrtar. Nuk është arritur ende që të kemi pagë të barabartë për gratë dhe burrat për punë të barabartë, ose për punë me vlerë të barabartë. Vazhdon ende diskriminimi gjinor në punësimin dhe ecjen përpara dhe që ka lidhje me shtatzëninë, përmes testimit për shtatzëni, dhe ngacmimit seksual në vendin e punës. Në disa vende, të drejtat e plota dhe të barabarta të grave për të zotëruar truall dhe pasuri të tjera, përfshirë edhe përmes së drejtës për trashëgimi, nuk është pranuar ende në legjislacionin kombëtar. Ecja përpara e grave, në shumicën e rasteve, mbetet ende më e vështirë për gratë, për shkak të mungesës së strukturës dhe masave që konsiderojnë përgjegjësitë pas lindjes së fëmijës dhe ato familjare. Në disa raste, sterotipi gjinor që vazhdon, ka çuar në një status më të ulët të burrave që janë baballarë dhe në një inkurajim të pamjaftueshëm për burrat që të balancojnë përgjegjësitë profesionale me ato familjare. Këto vështirësi rriten dhe nga mungesa e politikave mik-I-familjes, për organizimin e punës. Mbetet ende i dobët zbatimi me efektshmëri i sistemeve të legjislacionit dhe të mbështetjes praktike.

Kombinimi i punës së paguar dhe kujdesit për familjen, shtëpinë dhe komunitetin çon në një barrë të pabarabartë për gratë duke qënë se ka një ndarje të pamjaftueshme të detyrave dhe të përgjegjësiave nga burrat.

Gratë mbeten ende ato që kryejnë pjesën më të madhe të punës së papaguar.

G. Eomen in poëer and decision-making

22. *Achievements.* Ka një pranim në rritje të rëndësisë, që ka për shoqërinë, pjesëmarrja e plotë e grave në vendim-marrje dhe në pushtetin e të gjitha niveleve si dhe në forume, duke përfshirë sektorët ndërqeveritarë, qeveritarë dhe jo-qeveritarë. Në disa vende gratë kanë arritur pozicione më të larta në këto sfera. Një numër në rritje vendesh ka përdorur politika veprimi afirmuese, duke përfshirë sistemet e kuotimit ose marrëveshjet vullnetare në disa vende dhe objektiva dhe shënjestra të matshme, ka zhvilluar programe trajnimi për gratë në udhëheqje, dhe ka marrë masa për të balancuar përgjegjësitë e familjes dhe të punës si për gratë dhe për burrat. Janë krijuar, rritur ose forcuar, mekanizmat dhe makineritë kombëtare për përparimin e grave si dhe rrjetet kombëtare dhe ndërkombëtare të grave politikane, parlamentare, aktiviste dhe profesioniste në fusha të ndryshme.

23. *Pengesat.* Megjithë pranimin e nevojës për balancë gjinore në organet e vendim-marrjes në të gjitha nivelet, ka vazhduar hendeku ndërmjet barazisë de jure dhe de facto. Megjithë përmirësimin themelor të barazisë midis grave dhe burrave, pjesëmarrja reale e grave në nivelet më të larta të vendim-marrjes kombëtare dhe ndërkombëtare nuk ka ndryshuar shumë që nga Konferenca e Katërt Botërore në 1995, dhe përfaqësimi shumë i ulët i grave në organet vendim-marrëse të të gjitha fushave, përfshirë politikën, parandalimin e konfliktit dhe mekanizmat e rezolutës, ekonomi, mjedis dhe media, pengon përfshirjen e perspektivës gjinore në këto sfera kritike ndikimi. Gratë vazhdojnë të jetë shumë pak të përfaqësuara në nivelet e legjislativit, misteriale, dhe nën-ministeriale, si dhe në nivelet më të larta të sektorit të korporatës dhe institucioneve të tjera ekonomike dhe sociale. Rolet e përcaktuar tradicionalisht i kufizojnë zgjedhjet e grave për arsim dhe karrierë dhe i detyrojnë ato që të marrin një barrë për përgjegjësitë në shtëpi. Iniciativat dhe programet që synojnë në pjesëmarrjen më të madhe të grave në vendim-marrje janë penguar nga mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare për

trajnimin dhe mbështetjen për karrierë politike; qëndrimet gjinore ndaj grave në shoqëri; ndërgjegjësimit të grave për t'u angazhuar në vendim-marrje në disa raste; përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur dhe e partive politike për të çuar përpara barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në jetën publike; ndërgjegjësimit social për rëndësinë e pjesëmarrjes së balancuar të grave dhe burrave në vendim-marrje; vullneti nga ana e burrave për të ndarë pushtetin; dialog dhe bashkëpunim i mjaftueshëm me organizatat jo-qeveritare të grave, si dhe me strukturat organizative dhe politike, që ndihmojnë gratë për të marrë pjesë në të gjitha sferat e vendim-marrjes politike.

H. Mekanizmat institucionalë për përparimin e grave

24. *Arritjet.* Makineritë kombëtare janë forcuar dhe njohur si baza institucionale që veprojnë si katalizatorë të avancimit të barazisë gjinore, përfshirjen gjinore dhe monitorimin e zbatimit të Platformës së Veprimit dhe në shumë raste të Konventës për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Dhunës kundër Grave⁸. Në shumë vende, ka pasur progres në pikëpamje të dukshmërisë, statusit, edukimit dhe koordinimit të aktiviteteve të këtyre makinerive. Perspektiva gjinore pranohet si një strategji për rritjen e ndikimit të politikave në avancimin e barazisë gjinore. Qëllimi i strategjisë është trupëzimi i perspektivës gjinore në të gjithë legjislacionin, politikat, programet dhe projektet. Këto makineri, megjithë burimet e tyre, të kufizuara, financiare, kanë sjellë një kontribut domethënës për zhvillimin e burimeve njerëzore në fushën e studimeve gjinore. Ato kanë rritur përpjekjet për gjenerimin dhe shpërndarjen e të dhënave, të zberthyer sipas seksit dhe moshës si dhe kanë shtuar kërkimet dhe dokumentacionin me drejtim gjinor. Brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara është arritur përparim në përfshirjen e perspektivës gjinore, edhe përmes krijimit të instrumenteve dhe pikave fokale gjinore.

25. *Pengesat.* Në një numër vendesh, burimet e pamjaftueshme financiare dhe njerëzore dhe mungesa e vullnetit politik dhe e angazhimit janë pengesat kryesore që hasin makineritë kombëtare. Kjo thellohet më tej nga kuptimi i pamjaftueshëm i barazisë gjinore, nga mungesa e perspektivës gjinore në strukturat qeveritare, si dhe nga stereotipet dominuese, qëndrimet diskriminuese, prioritete të tjera të qeverisë, dhe në disa vende, mandatet e paqarta, pozicione të paqarta brenda strukturave qeveritare kombëtare, mungesë të dhënash të zberthyer sipas seksit dhe moshës në shumë fusha dhe metoda të pamjaftueshme të përdorura për vlerësimin e progresit, krahas autoritetit të dobët dhe lidhjeve të dobëta me shoqërinë civile. Aktivitetet e makinerive kombëtare janë penguar edhe nga probleme të komunikimit ndërmjet agjencive qeveritare dhe të strukturës së tyre.

I. Të drejtat e njeriut të grave

26. *Arritjet.* Janë ndërmarrë reforma ligjore për të penguar të gjitha format e diskriminimit dhe janë eliminuar dispozitat diskriminuese nga ligji civil, penal dhe i statusit personal që rregullon marrëdhëniet martesore dhe familjare, të gjitha format e dhunës, pasurinë e grave, të drejtat e pronësisë, veprimtarinë politike të grave, dhe të drejtat e punësimit. Janë marrë hapa për të realizuar gëzimin de facto të të drejtave të njeriut të grave përmes krijimit të mjediseve favorizuese, adoptimin e masave politike, përmirësimin e mekanizmave përforcues dhe monitorues, dhe organizimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe rritja e kulturës ligjore, në të gjitha

⁸ Rezoluta 34/180, aneksi

nivelet. Konventa për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave është ratifikuar nga njëqind e gjashtëdhjetë e pesë vende dhe zbatimi i saj i plotë është mbështetur nga Komiteti për Zhdukjen e Diskriminimit kundër Grave. Në sesionin e vet të pesëdhjetë e katërt Asambleja e Përgjithshme adoptoi Protokollin Opsional Të Konventës⁹, që lejon që, gratë që, pretendojnë se janë viktime të ndonjë shkeljeje nga një Shtet palë, të të drejtave, të tyre të parashtruara në Konventë, t'i depoziojnë pretendimet e tyre në Komitetin për Zhdukjen e Diskriminimit kundër Grave, gjë për të cilën kanë kontribuar organizatat jo-qeveritare duke rritur ndërgjegjësimin dhe duke mbështetur adoptimin e saj. Organizatat jo-qeveritare të grave kanë kontribuar edhe për ndërgjegjësimin se të drejtat e grave janë të drejtat të njeriut. Ato kanë mbështetur përfshirjen e perspektivës gjinore në sqarimin e Statutit të Romës për Gjykatën Kriminale Ndërkombëtare. Ka pasur progress edhe për integrimin e të drejtave të njeriut të grave dhe përfshirjen e perspektivës gjinore në sistemin e Kombeve të Bashkuara, edhe në punën e Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Të Drejtat e Njeriut.

27. *Pengesat.* Diskriminimi gjinor dhe të gjitha format e diskriminimit, në veçanti racizmi, diskriminimi racial, ksenofobia dhe mungesa e tolerancës vazhdojnë të kërcënojnë gëzimin e të drejtave, të njeriut dhe të lirive themelore nga gratë. Në situata konflikti të armatosur dhe pushtimi të huaj, të drejtat e njeriut të grave shkelen masivisht. Megjithëse një numër vendesh ka ratifikuar Konventën për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, nuk është arritur ende qëllimi i ratifikimit universal deri në vitin 2000. Ende vazhdon të ketë një numër të madh rezervash ndaj Konventës. Ndërsa ka një pranim në rritje të barazisë gjinore, shumë vende nuk i kanë zbatuar ende dispozitat e Konventës. Vazhdojnë ende legjislacioni diskriminues, praktikat e dëmshme tradicionale dhe zakonore dhe stereotipet negative të grave dhe burrave. Ligji për familjen, ligji civil, penal, ligjet ose kodet e punës dhe tregtar, rregullat dhe rregulloret administrative, nuk kanë integruar ende perspektivën gjinore. Hendeqet legjislative dhe rregullatore, si dhe mungesa e zbatimit dhe forcimit të legjislacionit dhe e rregulloreve, sjellin pabarazi dhe diskriminim de jure dhe de facto, dhe në disa raste, janë miratuar ligje të reja diskriminuese për gratë. Në shumë vende, gratë kanë qasje të pakët tek ligji, për shkak të analfabetizmit, mungesës së kulturës ligjore, mungesës së informacionit dhe të burimeve, pandjeshmërisë dhe anshmërisë gjinore, dhe mungesës së ndërgjegjësimit për të drejtat e njeriut të grave dhe dinjitetin dhe vlerën e personit. Ka njohje të pamjaftueshme për të drejtat riprodhuese të grave dhe të vajzave, si dhe pengesa për gëzimin e plotë të këtyre të drejtave, që përbëjnë disa nga të drejtat e njeriut si parashihet në paragrafin 95 të Platformës për Veprim të Beijing. Disa grad he vajza vazhdojnë të hasin pengesa në sistemin e drejtësisë dhe për gëzimin e të drejtave të tyre të njeriut për faktorë si raca, gjuha, etnia, kultura, feja, paaftësia fizike, ose klasa social-ekonomike ose pse ato janë indigjene, migrante, përfshirë gratë migrante që punojnë, gratë e zhvendosura dhe ato refugjate.

J. Gratë dhe media

28. *Arritjet.* Krijimi i rrjeteve vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare të mediave për gratë ka kontribuar për shpërndarjen globale të informacionit, shkëmbimin e pikëpamjeve dhe mbështetjen për grupet e grave që janë aktive në media. Zhvillimi i teknologjisë së

⁹ Rezoluta 54/4, aneks

informacionit dhe të komunikimit, veçanërisht Interneti, kanë ofruar mundësi komunikimi më të mira për fuqizimin e grave dhe të vajzave, çka ka bërë që një numër i madh grash të ndihmojnë për shkëmbimin e dijeve, aktivitete për njohjen me njëra tjetrën, dhe tregtimin elektronik. Është rritur numri i organizatave të medias dhe i programeve për gratë, duke ndihmuar në rritjen e pjesëmarrjes dhe njohjen me portrete pozitive grash në media.

Ka pasur progress në luftën kundër imazhit negative të grave përmes udhëzuesve profesionalë dhe kodit vullnetar të sjelljes, duke inkurajuar portretizimin e drejtë gjinor dhe përdorimin e një gjuhe jo-seksiste në programet e medias.

29. *Pengesat.* Imazhet negative, të dhunshme, dhe/ose degraduese të grave, përfshirë portretizimet stereotipike, janë shtuar përmes përdorimit të teknologjisë së komunikimit si dhe vazhdon anshmëria kundër grave në media. Varfëria, mungesa e qasjes dhe e mundësive, analfabetizmi, mosnjohja e kompjuterit, dhe pengesat gjuhësore, pengojnë gratë nga përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, duke përfshirë edhe internetin. Zhvillimi dhe qasja në infrastrukturën e internetit është e kufizuar, veçanërisht në vendet në zhvillim dhe veçanërisht për gratë.

K. Gratë dhe mjedisi

30. *Arritjet.* Disa politika dhe programe kombëtare mjedisore kanë përfshirë perspektivën gjinore. Duke kuptuar se barazia gjinore, çrrënjësja e varfërisë, zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e mjedisit, janë të lidhura me njëra tjetrën, Qeveritë kanë përfshirë në strategjitë e tyre të zhvillimit, aktivitete fitimprurëse për gratë, si dhe trajnime në manaxhimin e burimeve të natyrës dhe mbrojtjen e mjedisit.

Janë bërë projektete për ruajtjen dhe përdorimin e dijeve tradicionale ekologjike, përfshirë dijet tradicionale ekologjike të grave indigjene në manaxhimin e burimeve të natyrës dhe ruajtjen e biodiversitetit.

31. *Pengesat.* Vazhdon të ketë mungesë të ndërgjegjësimit publik për rreziqet mjedisore që hasin gratë dhe për të mirat e barazisë gjinore për çuarjen përpara të mbrojtjes mjedisore. Qasja e kufizuar e grave në shprehjet teknike, tek burimet dhe informacioni, në veçanti në vendet e zhvilluara, për shkak edhe të pabarazisë gjinore, ka penguar pjesëmarrjen efektive të grave në vendim-marrje, sa i takon mjedisit të qëndrueshëm dhe në nivel ndërkombëtar. Puna kërkimore, aksioni, strategjitë e shënjestruara dhe ndërgjegjësimi publik mbeten të kufizuara në lidhje me ndikimet dhe ndërlikimet e problemeve mjedisore për gratë dhe burrat. Zgjidhjet reale të problemeve mjedisore, përfshirë degradimin mjedisor, duhet të trajtojnë shkaqet në themel të këtyre problemeve, si pushtimi huaj. Politikat dhe programet mjedisore nuk kanë perspektivë gjinore dhe nuk marrin në konsideratë rolet dhe kontributet e grave për qëndrueshmërinë mjedisore.

L. The girl child

32. *Arritjet.* Ka pasur progress në edukimin fillor, dhe në njëfarë mase edhe në atë dytësor dhe tretësor për vajza, falë krijimit të një mjedisi shkollor me ndjeshmëri gjinore, një infrastrukturë të përmirësuar arsimore, rregjistrimit të një numri më të madh nxënësesh dhe vazhdimit të

shkollës nga ana e tyre, mekanizmave në mbështetje të mundësive arsimore dhe ndjekjes më të madhë të orëve shkencore dhe teknologjike. Vëmendje më e lartë i është kushtuar shëndetit të vajzave, përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues të adoleshenteve. Një numër i madh shtetesh ka miratuar legjislacion që ndalon gjymtimin femëror gjenital dhe ka vendosur ndëshkime më të rënda për ata që përfshihen në abuzimin seksual, trafikim dhe forma të tjera të shfrytëzimit të vajzave, përfshirë tregtimin e tyre. Një arritje e kohëve të fundit është adoptimi i protokolleve opsionale të Konventës për të Drejtat e Fëmijës mbi përfshirjen e fëmijës në konflikt të armatosur¹⁰ dhe për shitjen e fëmijëve, prostitucioni i fëmijëve dhe pornografia e fëmijëve¹¹.

33. *Pengesat*. Varfëria, qëndrimet diskriminuese ndaj grave dhe vajzave, qëndrimet negative kulturore dhe praktikat kundër grave, si dhe stereotipi negativ për vajzat dhe djemtë, që kufizon potencialin e vajzave dhe ndërgjegjësimin e papërshtatshëm për situata të caktuara të vajzave, punën e fëmijëve dhe barrën e rëndë të përgjegjësive në shtëpi për vajzat, ushqyerja e papërshtatshme dhe qasja e pakët tek shërbimet shëndetësore, mungesa e mjeteve financiare, që shpesh i pengon ato që të ndjekin dhe kryejnë arsimin dhe trajnimin, kanë çuar në mungesën e mundësive për vajzat që të fitojnë besim dhe të mbështeten në forcat e tyre dhe të bëhen të pavarura. Varfëria, mungesa mbështetjes dhe drejtimit prindëror, mungesa e informacionit dhe arsimimit, abuzimi dhe të gjitha format e shfrytëzimit dhe të dhunës kundër vajzave në shumë raste rezultojnë në shtatzëni të padëshiruara dhe në transmetimin e HIV, që mund të çojë edhe në kufizimin e mundësive për arsim. Programet për vajzat janë penguar nga mungesa ose pamjaftueshmëria e burimeve financiare dhe njerëzore. Ka pasur pak mekanizma kombëtarë për zbatimin e politikave dhe të programeve për vajzat dhe në disa raste koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse ishte i pamjaftueshëm. Ndërgjegjësimi në rritje për nevojat shëndetësore, përfshirë ato të shëndetit seksual dhe riprodhues, të adoleshenteve nuk ka çuar ende në dhënien e informacionit dhe të shërbimeve të mjaftueshme për to. Megjithë përparimet në mbrojtjen ligjore, abuzimi dhe shfrytëzimi seksual i vajzave është shtuar. Adolehentet vazhdojnë të mos kenë arsim dhe shërbimet që u duhen për t'i aftësuar ato që të trajtojnë në mënyrë pozitive dhe të përgjegjshme seksualitetin e tyre.

III. Sfidat aktuale që ndikojnë mbi zbatimin e plotë të Deklaratës së Beijing dhe Platformën e Veprimit

34. Rishikimi dhe vlerësimi i zbatimit të Deklaratës së Beijing dhe i Platformës për Veprim janë bërë në një kontekst global që ndryshon shpejt. Qysh prej 1995, kanë fituar rëndësi dhe dimensione të reja një numër çështjesh që sjellin sfida të reja për zbatimin e plotë dhe të shpejtë të Platformës për Veprim të Beijing dhe për realizimin e barazisë gjinore, zhvillimin dhe paqen nga Qeveritë, organet ndër-qeveritare, organizatat ndërkombëtare, sektori privat dhe organizatat jo-qeveritare, sipas rastit. Për zbatimin e plotë të Platformës për Veprim nevojitet angazhimi i vazhdueshëm politik për barazi gjinore në të gjitha nivelet.

35. Globalizimi ka sjellë sfida të reja për plotësimin e angazhimeve dhe realizimin e qëllimeve të Konferencës së Katërt Botërore për Gratë. Procesi i globalizimit në disa vende, ka çuar në ndryshime politikash në favor të një tregu dhe fluksi financiar më të hapur, privatizimin e

¹⁰ Rezolutë 54/263, aneks I.

¹¹Ibid., aneks II.

ndërmarrjeve shtetërore dhe në shumë raste shpenzime më të pakta publike, veçanërisht për shërbimet sociale. Ky ndryshim ka transformuar modelet e prodhimit dhe ka përshpejtuar përparimin teknologjik në informacion dhe komunikim dhe ka ndikuar jetët e grave, si atyre punëtore dhe atyre konsumatore. Në një numër të madh vendesh, veçanërisht në vendet në zhvillim dhe ato të zhvilluara, këto ndryshime kanë ndikuar negativisht në jetët e grave dhe kanë rritur pabarazinë. Ndikimi gjinor i këtyre ndryshimeve nuk është vlerësuar sistematikisht. Globalizimi ka edhe ndikime kulturore, politike, dhe sociale mbi vlerat kulturore, stilet e jetës, format e komunikimit si dhe qëndrueshmërinë e zhvillimit.

Përfitimet e rritjes së ekonomisë globale janë shpërndarë në mënyrë të panjëtrajtshme, duke çuar në pabarazi më të mëdha ekonomike, feminizimi i varfërisë, pabarazia më e lartë gjinore, përfshirë kushte më të këqëja dhe të pasigurta pune, veçanërisht në ekonominë jozyrtare dhe në zonat fshatare. Ndërsa globalizimi ka sjellë mundësi më të mëdha ekonomike dhe pavarësi më të madhe për disa gra, shumë të tjera janë veçuar dhe privuar nga përfitimet e këtij procesi, për shkak të pabarazive që thellohen brenda një vendi dhe ndërmjet vendeve të ndryshme. Megjithëse në shumë vende niveli i pjesëmarrjes së grave si forcë pune është rritur, në disa raste përdorimi i disa politikave ekonomike ka pasur ndikim të tillë negativ që rritja e punësimit të grave nuk ka sjellë në rritje të pagave të tyre, në ecje përpara të tyre dhe as në përmirësim të kushteve të punës. Në shumë raste, gratë vazhdojnë që të punësohen në punë me kontratë, me orë të pjesshme që mbartin pasiguri dhe rreziqe për shëndetin. Në shumë vende, gratë, veçanërisht ato që sapo janë futur në tregun e punës, vazhdojnë të jenë ndër të parat që humbasin punën dhe ndër të fundit që punësohen.

36. Pabarazitë ekonomike në rritje brenda një vendi dhe ndërmjet vendeve të ndryshme, mbledhur edhe me ndërvarësinë ekonomike në rritje dhe varësinë e Shteteve nga faktorë të jashtëm si dhe krizat financiare kanë ndryshuar shpresën për rritje dhe kanë shkaktuar destabilitet ekonomik në shumë vende, me një ndikim të madh në jetët e grave. Këto vështirësi kanë ndikuar mbi aftësinë e Shteteve për të dhënë mbrojtje dhe siguri sociale si dhe për të financuar zbatimin e Platformës për Veprim. Këto vështirësi janë reflektuar edhe në kalimin e barrës së kostos për mbrojtje, siguri sociale dhe dispozita të tjera të mirëqënies sociale nga sektori publik mbi familjet. Nivelet në rënie të financimit të ofruar nga bashkëpunimi ndërkombëtar kanë kontribuar për veçimin e mëtejshëm të një numri të madh vendesh në zhvillim dhe vendesh me ekonomi në tranzicion, vende ku gratë janë ndër më të varfërat. Nuk është arritur që, si është rëndë dakord, 0.7 për qind e produktit bruto vendas të vendeve të zhvilluara të shkojë për ndihmën zyrtare për zhvillim. Këta faktorë kanë kontribuar për rritjen e feminizimit të varfërisë, që ka minuar përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore. Financimi i kufizuar në nivel Shteti e bën të domosdoshëm përdorimin e taktikave inovative për shpërndarjen e burimeve ekzistuese, jo vetëm nga Qeveritë por edhe nga organizatat jo-qeveritare dhe sektori privat. Një novacion i tillë është edhe analiza gjinore për buxhetet publike, që po shfaqet si një mjet i rëndësishëm për përcaktimin ndikimit të shpenzimeve që ndryshojnë ndërmjet grave dhe burrave. Kjo analizë është vendimtare për të çuar përpara barazinë gjinore.

37. Ndikimi i globalizimit dhe programet për rregullimet sktrukturore, kostot e larta të borxhit të jashtëm dhe rënia e tregtisë ndërkombëtare në disa vende të zhvilluara, kanë përkeqësuar pengesat ekzistuese ndaj zhvillimit, duke rënduar feminizimin e varfërisë. Pasojat negative të programeve për rregullime strukturore, që burojnë nga hartimi dhe përdorimi i papërshtatshëm

kanë vazhduar të jenë një barrë më e madhe për gratë, përmes pakësimit të buxhetit për shërbimet sociale bazë, përfshirë arsimin dhe shëndetin.

38. Ka një pranim më të madh që barra në rritje e borxhit me të cilin përballen shumica e vendeve në zhvillim është e paqëndrueshme dhe përbën një nga pengesat kryesore për zhvillimin që ka në qëndër njerëzit dhe çrënjosjen e varfërisë. Për shumë vende në zhvillim, si dhe për vendet me ekonomi në tranzicion, borxhi tepër i madh ka kufizuar mundësitë e tyre për zhvillim social dhe për të dhënë shërbime bazë dhe ka ndikuar zbatimin e plotë të Platformës për Veprim.

39. Në vendet me ekonomi në tranzicion, gratë mbajnë shumicën e barrës së shkaktuar nga ristrukturimi ekonomik dhe janë të parat që humbasin punën në kohë krize ekonomike. Ato nxirren nga sektorët që rriten shpejt. Mbyllja e pikave që kujdesen për fëmijët për shkak të eliminimit ose privatizimit të vendeve shtetërore të punës, nevoja më e madhe për kujdes për të moshuar në kushtet kur mungojnë njësitë e këtij lloj kujdesi, dhe pabarazia në marrjen e trajnimit për t'u ri-punësuar dhe pabarazia në marrjen e zotërimeve prodhuese, për të hyrë dhe zgjeruar bizneset, janë sfida që hasin gratë në këto vende.

40. Shkenca dhe teknologjia, si përbër themelorë të zhvillimit, janë modele transformuese për prodhimin. Ato kontribuojnë në krijimin e vendeve të punës, në mënyrat e të punuarit, dhe në krijimin e një shoqërie që mbështetet në dije. Ndryshimi teknologjik mund të sjellë mundësi të reja për gratë në të gjitha fushat, nëse ato qasje të barabartë dhe trajnimit e përshtatshëm. Gratë duhet të jenë edhe të përfshira aktivisht në përkufizimin, krijimin, zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e ndikimit gjinor të politikave që lidhen me këto ndryshime. Shumë gra në mbarë botën nuk përdorin ende këto teknologji të reja të komunikimit për t'u lidhur me njerëz të tjerë, për të mbrojtur çështjet e tyre, për të shkëmbyer informacion, për biznes, për arsim, media, dhe iniciative të tregtimit elektronik. Për shembull, miliona gra dhe burra të varfër nuk kanë ende qasje në shkencë dhe teknologji dhe janë përjashtuar nga kjo fushë e re dhe mundësitë që ajo sjell.

41. Modelet e flukseve migratore të punës po ndryshojnë. Gratë dhe vajzat gjithnjë e më shumë po përfshihen në migrimin për punë brenda vendit, rajonit dhe botës, kryesisht në fermë, punë shtëpie dhe në fushën e argëtimit. Ndërsa kjo situatë rrit mundësitë e tyre për fitim dhe mbështetje në forcat e veta, ajo i ekspozon ato, veçanërisht të varfërat, të paarsimuarat, të pakualifikuarat dhe/ose migrantet pa dokumente, ndaj kushteve të papërshtatshme të punës, rrezikut më të madh për shëndetin, rrezikut të trafikimit, shfrytëzimit ekonomik dhe seksual, racizmit, diskriminimit racial, dhe ksenofobisë, dhe formave të tjera të abuzimit, që dëmton gëzimin e tyre të drejtave të njeriut dhe në disa raste përbën shkelje të drejtave të njeriut.

42. Ndërsa pranohet se Qeveritë kanë përgjegjësi parësore për zhvillimin dhe zbatimin e politikave për arritjen e barazisë gjinore, partneritetet ndërmjet qeverive, dhe aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile po shihen gjithnjë e më shumë si mekanizëm i rëndësishëm për të arritur këtë qëllim. Mund të zhvillohen taktika të tjera novatore mund të zhvillohen për të forcuar këtë bashëpunim.

43. Në disa vende, tendencat demografike tregojnë se norma më e ulët lindjeve, jetëgjatësia më e madhe dhe vdekshmëria më e ulët kanë sjellë plakjen e popullsisë, dhe rritja e sëmundjeve kronike ka ndikuar në sistemet e kujdesit shëndetësor dhe shpenzimet, sistemet jozyrtare të kujdesit dhe punën kërkimore. Hendeku ndërmjet jetëgjatësisë së grave dhe të burrave, numri i vejshave dhe i grave të moshuara beqare është rritur shume, duke çuar në izolimin e tyre shoqëror dhe në të tjera sfida shoqërore. Shoqëritë kanë shumë për të fituar nga dija dhe përvoja jetësore e grave të moshuara. Nga ana tjetër, brezi i sotëm i të rinjve është më i madhi në histori. Adoleshentet dhe të rejtat kanë nevojë të veçanta që kërkojnë vëmendje më të madhe.

44. Përparimi i shpejtë i pandemisë HIV/AIDS, në veçanti në vendet e zhvilluara, ka pasur ndikime shkatërruese për gratë. Sjellja e përgjegjshme dhe barazia gjinore janë ndër kushtet më të rëndësishme për parandalimin e saj. Nevojiten gjithashtu strategji më efektive për fuqizimin e grave për të kontrolluar dhe vendosur lirisht dhe me përgjegjësi për çështje që lidhen me seksualitetin e tyre, për të mbrojtur veten nga sjellje të rrezikshme dhe të papërgjegjshme që çojnë në infeksione seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS, dhe për të nxitur sjellje të përgjegjshme, të sigurt dhe të respektueshme nga burrat, duke nxitur edhe barazinë gjinore. HIV/AIDS është çështje urgjente e shëndetit publik, që po përhapet me shpejtësi, dhe në shumë vende po përmbys zhvillimin e arritur me vështirësi.

Barra e kujdesit për njerëzit që jetojnë me HIV/AIDS dhe për fëmijët e mbetur jetim nga HIV/AIDS bie veçanërisht mbi gratë ndërsa infrastrukturat janë të papërshtatshme për t'iu përgjigjur sfidave të paraqitura. Gratë me HIV/AIDS shpesh vuajnë nga diskriminimi dhe stigma dhe janë shpesh viktimat e dhunës. Nuk janë trajtuar mjaftueshëm çështjet që lidhen me parandalimin, transmetimin e HIV nga nëna tek fëmija, ushqyerjen me gjë, informacionin dhe arsimimin në veçanti të rinisë, sjellja e rrezikshme, përdoruesit e drogës intravenoze, grupet mbështetëse, këshillimi dhe testimi vullnetar, njoftimi i partnerit dhe dhënia e ilaçeve dhe çmimet e larta të ilaçeve kryesore. Ka shenja pozitive në luftën kundër HIV/AIDS në disa vende ku kanë ndodhur ndryshime të sjelljes ndër të rinjtë, dhe përvoja tregon se programet edukuese për të rinj mund të çojnë në një shikim më pozitiv të marrëdhënieve gjinore dhe barazisë gjinore, vonimin e marrëdhënies së parë seksuale, ulje e rrezikut për infeksionet seksualisht të transmetueshme.

45. Rritja e abuzimit me drogat dhe substancat ndër gratë dhe vajzat, si në vendet e zhvilluara ashtu dhe ato në zhvillim, ka rritur nevojën për më shumë përpjekje për pakësimin e kërkesës dhe luftën kundër prodhimit të illegal, furnizimit, dhe trafikimit të narkotikëve dhe substancave psikotrope.

46. Rritja e numrit të të vrarëve dhe e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ka rritur ndërgjegjësimin se taktikat ekzistuese dhe metodat e ndërhyrjes në përgjigje të këtyre situatave emergjente nuk janë efçente dhe të përshtatshme, dhe se gratë më shumë se burrat mbajnë barrën e përgjegjësisë për t'iu përgjigjur nevojave të përditshme të familjeve të tyre. Kjo situatë ka rritur ndërgjegjësimin se duhet trupëzuar një perspektivë gjinore kurdoherë që, hartohen dhe zbatohen strategji për parandalimin e fatkeqësive, lehtësimin dhe shërimin e pasojave.

47. Konteksti në ndryshim i marrëdhënieve gjinore, si dhe diskutimi i barazisë gjinore, ka çuar në një ri-vlerësim të roleve gjinore. Kjo ka inkurajuar më tej një diskutim për rolet dhe përgjegjësitë e grave dhe burrave për të punuar së bashku për barazinë gjinore për të ndryshuar

rolet stereotipike dhe tradicionale që kufizojnë potencialin e plotë të grave. Ekziston nevoja për pjesëmarrje të balancuar të grave dhe të burrave në punën e paguar dhe të papaguar. Dështimi për të dalluar dhe matur në pikëpamje sasiore punën e papaguar të grave, që shpesh nuk vlerësohet as në llogaritë kombëtare, do të thotë se kontributi i grave për zhvillimin social dhe ekonomik mbetet i pavlerësuar dhe i nënçmuar.

Për sa kohë që nuk ka një ndarje të mjaftueshme detyrash dhe përgjegjësish me burrat, kombinimi i punës dhe i kujdestarisë do të çojë në një barrë shumë më të madhe për gratë sesa me burrat.

IV. Veprimet dhe nismat për të kapërcyer pengesat dhe për të arritur zbatimin e plotë dhe të përsheptuar të Platformës për Veprim të Beijing

48. Duke parë vlerësimin e progresit të bërë në pesë vite që nga Konferenca e Katërt Botërore për Gratë, për zbatimin e Deklaratës dhe Platformës për Veprim të Beijing, si parashihet në seksionin II më lart, si dhe sfidat e tanishme, si parashihet në seksionin III më lart, qeveritë ri-angazhohen për Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Beijing dhe angazhohen për veprime të mëtejshme, iniciativa për të kapërcyer pengesat dhe për të trajtuar sfidat. Qeveritë, gjatë hedhjes së hapave të pandalshëm për të arritur qëllimet e Platformës së Veprimit, pranojnë se të gjitha të drejtat e njeriut – civile, kulturore, ekonomike, politike, dhe sociale, përfshirë të drejtën për zhvillim – janë universale, të pandashme, të ndërvarura dhe të ndërlidhura dhe janë themelore për realizimin e barazisë gjinore dhe të paqes në shekullin e njëzetë e një.

49. Organizatat e sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe institucionet Bretton Woods, si dhe Organizata Botërore e Tregtisë, organe të tjera ndërkombëtare dhe rajonale, parlamentet dhe shoqëria civile, përfshirë sektorin privat dhe organizatat jo-qeveritare, sindikatat dhe palë të tjera të interesit, thirren për të mbështetur përpjekjet e qeverisë dhe, kur është e përshtatshme, të zhvillojnë programe plotësuese për të arritur zbatimin e plotë dhe të efektshëm të Platformës për Veprim.

50. Qeveritë dhe organizatat ndërqeveritare dallojnë kontributin dhe rolin plotësues të organizatave jo-qeveritare, me respekt të plotë për pavarësinë e tyre, për garantimin e zbatimit efektiv të Platformës për Veprim, dhe duhet të vazhdojnë që të forcojnë partneritetet me organizatat jo-qeveritare veçanërisht organizatat e grave, për të kontribuar për zbatimin efektiv dhe ndjekjen e Platformës për Veprim.

51. Përvoja ka treguar se qëllimi i barazisë gjinore mund të arrihet plotësisht vetëm në kontekstin e marrëdhënieve të freskuara ndërmjet palëve të ndryshme të interesit në të gjitha nivelet. Pjesëmarrja e plotë, efektive e grave mbështetur në barazinë në të gjitha sferat e shoqërisë është e nevojshme për t'i kontribuar këtij qëllimi.

52. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave kërkojnë ndreqjen e pabarazive ndërmjet grave dhe burrave dhe vajzave dhe djemve dhe garantimin e të drejtave, përgjegjësive, shanseve dhe mundësive të tyre, të barabarta. Barazia gjinore nënkupton që nevojat, interesat, shqetësimet, përvojat dhe prioritetet e grave si dhe ato të burrave të jenë një dimension përbërës i hartimit, zbatimit, monitorimit kombëtar, dhe ndjekjes dhe vlerësimit të veprimeve në të gjitha fushat, përfshirë në nivel ndërkombëtar.

53. Përmes adoptimit të Platformës për Veprim, qeveritë dhe komuniteti ndërkombëtar kanë rënë dakord për një plan të përbashkët zhvillimi që ka si parime themelore barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Përpyekjet drejt garantimit të pjesëmarrjes së grave në zhvillim janë zgjeruar për këtë arsye kërkohet që fokusimi në kushtet dhe nevojat bazë të grave të kombinohet me një trajtim tërësor që bazohet në të drejtat dhe partneritetet e barabarta, mbështetjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore. Politikat dhe programet duhet të riformulohen për të arritur zhvillimin që ka në qëndër njeriun, jetesën e sigurt, dhe masat e përshtatshme për mbrojtjen sociale, qasjen në burimet financiare dhe ekonomike dhe kontrollin mbi to, dhe për të eliminuar varfërinë në rritje të grave. Të gjitha politikat dhe institucionet ekonomike si dhe ato përgjegjëse për caktimin e burimeve duhet të adoptojnë një perspektivë gjinore për të garantuar që dividendët e zhvillimit të shpërndahen me barazi.

54. Duke marrë parasysh barrën në rritje të varfërisë së grave në shumë vende, veçanërisht në ato të varfëra, është themelore që të vazhdojë rishikimi, modifikimi, dhe zbatimi nga pikëpamja gjinore i politikave dhe programeve të integruara sociale dhe makroekonomike, si dhe përmirësimet strukturore, dhe të borxhit të jashtëm, për të garantuar qasjen universale dhe të barabartë në shërbimet sociale, në veçanti në lidhje me arsimin dhe shërbimet shëndetësore cilësore të përbalueshme dhe qasje të barabartë dhe kontroll mbi burimet ekonomike.

55. Nevojiten përpjekje më të mëdha për të siguruar qasje të barabartë në shërbimet arsimore, shëndetësore dhe shoqërore, për të garantuar të drejtat e grave dhe të vajzave për arsim, gëzimin e standardit më të lartë të shëndetit fizik dhe mendor, dhe mirëqënie gjatë tërë jetës së tyre, si dhe kujdes dhe shërbime shëndetësore të përshtatshme, të përbalueshme dhe të hapura për të gjithë, ku përfshihen shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, veçanërisht në situatën e një pandemie të HIV/AIDS; ato janë të nevojshme edhe për numrin në rritje të grave të moshuara.

56. Duke qënë se shumica e grave të botës janë prodhuese të ushqimit dhe përdoruese të burimeve mjedisore, ekziston nevoja për të njohur dhe integruar dijet dhe prioritetet e grave për ruajtjen dhe manaxhimin e këtyre burimeve për të garantuar qëndrueshmërinë e tyre. Nevojiten programe dhe infrastruktura me orientim gjinor për t'iu përgjigjur me efektshmëri fatkeqësive dhe situatave të urgjencës që kërcënojnë mjedisin, sigurinë e jetesës, si dhe manaxhimin e kërkesave të jetës së përditshme.

57. Sustaining the livelihoods of populations in States with limited or scarce resources, including small island developing States, is critically dependent on the preservation and protection of the environment. Women's customary knowledge, management and sustainable use of biodiversity should be recognized.

58. Vullneti politik dhe angazhimi në të gjitha nivelet janë vendimtare për garantimin e përfshirjes së perspektivës gjinore në adoptimin dhe zbatimin e politikave gjithëanshme dhe të orientuara nga veprimi në të gjitha fushat. Angazhimet e politikëbërjes janë themelore për zhvillimin e mëtejshëm të kornizës së nevojshme që garanton qasjen e barabartë të grave, kontrollin e tyre mbi burimet ekonomike dhe financiare, qasjen e tyre tek trajnimi, shërbimet dhe institucionet si dhe pjesëmarrjen e tyre në vendim-marrje dhe manaxhim. Proceset e politikë-bërjes kërkojnë partneritetin e grave dhe të burrave në të gjitha nivelet. Burrat dhe

djemtë duhet të prfshihen aktivisht në të gjitha përpjekjet për të arritur qëllimet e Platformës për Veprim dhe zbatimin e saj.

59. Dhuna kundër grave dhe vajzave është pengesa kryesore për arritjen e objektivave të barazisë gjinore, zhvillimit dhe paqes. Dhuna kundër grave dhunon dhe dëmton ose zhduk gëzimin nga gratë të të drejtave të tyre të njeriut dhe të lirive themelore. Dhuna me bazë gjinore, si rrahja, dhuna në familje, abuzimi seksual, skllavërimi dhe shfrytëzimi seksual, trafikimi ndërkombëtar i grave dhe vajzave, prostitucioni i detyruar dhe ngacmimi seksual, si dhe dhuna ndaj grave që vjen nga paragjykimet kulturore, racizmi dhe diskriminimi racial, ksenofobia, pornografia, pastrimi etnik, konflikti i armatosur, pushtimi i huaj, ekstremizmi fetar dhe anti-fetar dhe terrorizmi janë të papërputhshme me dinjitetin dhe vlerën e personit dhe duhet të luftohen dhe të eliminohen.

60. Gratë luajnë një rol kritik në familje. Familja është njësi bazë e shoqërisë dhe është një forcë e fuqishme për kohezionin dhe integrimin social, si e tillë, ajo duhet forcuar. Mbështetja e papërshtatshme për gratë dhe mbrojtja e pamjaftueshme dhe mbështetja e familjeve të tyre ndikojnë shoqërinë dhe minojnë përpjekjet për arritur barazinë gjinore. Në sisteme të ndryshme kulturore, politike, dhe shoqërore, ekzistojnë forma të ndryshme të familjes dhe duhet të respektohen të drejtat, mundësitë dhe përgjegjësitë e anëtarëve të familjes. Kontributet shoqërore dhe ekonomike të grave për mirëqënien e familjes dhe për domethënien shoqërore të mëmësisë dhe atësisë vazhdojnë të trajtohen në mënyrë të papërshtatshme. Amësia dhe atësia, roli i prindërve dhe i kujdestarëve ligjore në familje, dhe në rritjen e fëmijëve dhe rëndësia e të gjithë anëtarëve të familjes për mirëqënien e familjes dihen dhe nuk duhet të bëhen bazë për diskriminim. Gratë vazhdojnë të mbajnë një barrë të pabarabartë të përgjegjësive në familje dhe kujdesin për fëmijët, të sëmurët dhe të moshuarit. Kjo pabarazi duhet të trajtohet nga politika dhe programet më të përshtatshme, në veçanti ato për arsimimin dhe legjislacionin. Me qëllim arritjen e partneritetit të plotë, si në sferën publike dhe në atë private, gratë dhe burrat duhet të aftësohen për të ndarë në mënyrë të barabartë përgjegjësitë dhe përgjegjësitë në familje.

61. Makineritë e fuqishme kombëtare që punojnë për avancimin e grave dhe nxitjen e barazisë gjinore kërkojnë angazhim politik të nivelit më të lartë, burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për të nisur, rekomanduar dhe lehtësuar zhvillimin, adoptimin dhe monitorimin e politikave, legjislacionit, programeve për ndërtimin e kapaciteteve për fuqizimin e grave, për të vepruar si katalistë për dialog të hapur me publikun mbi barazinë gjinore si qëllim i mbarë shoqërisë. Kjo do t'u mundësonte atyre që të mbështesin avancimin e grave dhe të përfshijnë perspektivën gjinore në politikat dhe programet e të gjitha fushave, për të luajtur një rol mbrojtës dhe për të garantuar qasje të barabartë në të gjithë institucionet dhe burimet, si dhe për të zgjeruar krijimin e kapaciteteve për gratë në të gjithë sektorët. Reformat për përballimin e sfidave të një bote në ndryshim, të vazhdueshëm, janë tejet të rëndësishme për garantimin e qasjes së barabartë të grave në institucionet dhe organizatat. Ndryshimet institucionale dhe konceptuale janë një aspekt i rëndësishëm, strategjik për krijimin e një mjedisi që mundëson zbatimin e Platformës për Veprim.

62. Mbështetja programore për rritjen e shanseve, potencialit dhe aktiviteteve të grave duhet të ketë fokus të dyfishtë:

Nga njëra anë, programe që synojnë plotësimin e nevojave bazë dhe specifike të grave për ndërtim kapacitetesh, zhvillim organizativ dhe fuqizim të tyre, dhe nga ana tjetër, përfshirje të perspektivës gjinore në të gjithë formulimin e programit dhe të aktiviteteve zbatuese. Është veçanërisht e rëndësishme mbështetja të shtrihet në fusha të reja për të çuar përpara barazinë gjinore në përgjigje të sfidave aktuale.

63. Vajzat dhe gratë e të gjitha moshave me çfarëdo lloj paaftësie janë përgjithësisht ndër më të dobëtat dhe më të veçuarat nga shoqëria. Për këtë arsye ekziston nevoja që të merret në konsideratë dhe të trajtohen shqetësimet e tyre në të gjithë politikë-bërjen dhe programimin. Nevojiten masa të posaçme në të gjitha nivelet për t'i integruar ato në rrymën e zhvillimit.

64. Planet dhe programet e efektshme dhe të koordinuara për zbatimin e plotë të Platformës së Veprimit kërkojnë njohje të qartë të situatës së grave dhe të vajzave, dije të qarta të bazuara në punë kërkimore dhe në të dhëna të zërthyera sipas seksit, në plane afatgjatë dhe afatshkurtër, në objektiva të matshme, dhe në mekanizma për vlerësimin e përparimit. Nevojiten përpjekje për të garantuar ndërtimin e kapaciteteve për të gjitha palët e përfshira në arritjen e këtyre objektivave. Përpjekje duhen edhe në nivel kombëtar për të rritur transparencën dhe llogaridhënien.

65. Realizimi dhe arritja e objektivave për barazi gjinore, zhvillim dhe paqe kërkon burimet e nevojshme njerëzore, financiare dhe materiale për aktivitete të veçanta dhe të shënjestruara për të garantuar barazinë gjinore në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar si dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje e veçantë këtyre objektivave në proceset buxhetore në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

**A. Actions to be taken at the national level
By Governments:**

66. (a) Krijimi dhe inkurajimi i përdorimit të synimeve të qarta afatgjatë dhe afatshkurtër ose të objektivave të matshëm, duke përfshirë, kur është e mundur, kuotat, për të nxitur përparimin drejt balancës gjinore, ku përfshihet qasja e barabartë e grave dhe pjesëmarrja e tyre, e plotë, mbështetur në barazinë me burrat, në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet e jetës publike, veçanërisht në pozicionet e vendim-marrjes dhe të politikë-bërjes, në partitë dhe aktivitetet politike, në të gjitha ministrinë e qeverisë dhe në institucionet kyçe të politikë-bërjes, si dhe në organet dhe autoritetet e zhvillimit lokal;

(b) Trajtimi i pengesave që hasin gratë, veçanërisht ato indigjene dhe gratë e tjera, të veçuara, në qasjen dhe pjesëmarrjen në politikë, dhe vendim-marrje, përfshirë mungesën e trajnimit, barra e dyfishtë e punës së paguar dhe të papaguar të grave, qëndrimet dhe stereotipet negative, shoqërore.

67. (a) Të garantohen politika që sigurojnë qasjen e barabartë në arsim, eliminimin e pabarazive gjinore në arsim, përfshirë trajnimin profesional, shkencë dhe teknologji, kryerjen e arsimit bazë nga vajzat, veçanërisht vajzat që jetojnë në zona fshatare dhe të privuara, dhe mundësitë për vazhdimin e shkollimit në të gjitha nivelet për gratë dhe vajzat;

(b) Të mbështesë zbatimin e planeve dhe të programeve të veprimit për të garantuar arsimin cilësor, numër më të lartë regjistrimesh në shkollë, vazhdimin e shkollës nga një numër më i madh djemsh dhe vajzash, eliminimin e diskriminimit gjinor dhe të stereotipeve gjinore nga programet dhe materialet edukative, si dhe nga procesi i edukimit;

(c) Të përshpejtojë veprimin dhe të forcojë angazhimin politik për të mbyllur hendekun gjinor në arsimin fillor dhe dytësor deri në 2005 dhe të garantojë arsimin e detyruar, falas, fillor për vajzat dhe djemtë deri në 2005, ashtu si kërkohet nga konferencat botërore, dhe të zhdukë politikat që kanë përkeqësuar dhe thelluar hendekun;

(d) Të zhvillojnë programe me perspektivë gjinore nga kopshti, në shkollën fillore, në trajnimin profesional dhe universitetet në mënyrë që të trajtohen stereotipet gjinore si një nga shkaqet e segregacionit gjatë punës.

68. (a) të hartohen dhe të zbatohen politika që nxisin dhe mbrojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për gratë dhe krijojnë një mjedis që nuk toleron dhunimin e të drejtave të grave dhe të vajzave;

(b) të krijojnë dhe të mbajnë një mjedis ligjor, jo-diskriminues dhe me ndjeshmëri gjinore përmes rishikimit të legjisllacionit me qëllim heqjen e dispozitave diskriminuese sa më parë të jetë e mundur, preferimisht deri në 2005, dhe eliminimin e hendeqeve ligjore që i lënë gratë dhe vajzat pa mbrojtje për të drejtat e tyre dhe pa ndihmë efektive në rast të diskriminimit me bazë gjinore;

(c) të ratifikojnë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, të kufizojnë çdo rezervë kundër Konventës, dhe të heqin çdo rezervë kundër objektit dhe qëllimit të Konventës ose çdo papërputhshmëri me ligjin e traktatit ndërkombëtar;

(d) Të shohin mundësinë për nënshkrimin dhe ratifikimin e Protokollit Opsional për Konventën për Zhdukjen e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave;

(e) Të shohin mundësinë për nënshkrimin dhe ratifikimin e Statutit të Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale;

(f) Të zhvillojnë, rishikojnë dhe zbatojnë ligjet dhe procedurat për të ndaluar dhe eliminuar të gjitha format e diskriminimit kundër grave dhe vajzave;

(g) Të marrin masa, përfshirë programet dhe politikat, për të garantuar që leja e lindjes, mëmësia dhe prindësimi dhe roli i grave në krijimin e jetës të mos përdoren si bazë për diskriminimin dhe as të mos kufizojnë pjesëmarrjen e plotë të grave në shoqëri;

(h) të garantojnë që proceset e reformës kombëtare ligjore dhe administrative, përfshirë ato që lidhen me reformën e tokës, decentralizimin dhe riorientimin e ekonomisë, të çojnë përpara të drejtat e grave, veçanërisht të atyre fshatare dhe grave që jetojnë në varfëri, dhe të marrin masa për të nxitur dhe zbatuar këto të drejta përmes qasjes së barabartë të grave në burimet

ekonomike dhe kontrollin e tyre mbi to, përfshirë truallin, të drejtat pronësore, të drejtën për trashëgimi, kredinë dhe skemat tradicionale të kursimeve, të tilla si bankat dhe kooperativat e grave;

(i) Të fusin perspektivën gjinore në rrjedhën e politikave kombëtare të imigrimit dhe të azilit, rregulloret dhe praktikat, sipas rastit, në mënyrë që të nxisë dhe mbrojë të drejtat e të gjitha grave, përfshirë konsiderimin e hapave për të dalluar persekutimin me bazë ligjore dhe dhunën kur vlerësohen bazat për dhënien e statusit të refugjatit dhe të azilantit;

(j) Të merren të gjitha masat e përshtatshme për të zhdukur diskriminimin kundër grave dhe vajzave nga persona, organizata ose ndërmarrje;

(k) të merren masat e nevojshme në sektorin privat dhe në arsim për të lehtësuar dhe forcuar zbatimin e legjislacionit jo diskriminues.

69. (a) Është prioritar, rishikimi i legjislacionit, me qëllim futjen e legjislacionit efektiv, përfshirë legjislacionin kundër dhunës. Gjithashtu, të merren masa të tjera të nevojshme për të garantuar se të gjitha gratë dhe vajzat janë të mbrojtura ndaj të gjitha formave të dhunës fizike, psikologjike dhe seksuale, dhe që ato gjejnë shpëtim tek drejtësia;

(b) Ndjekja ligjore e autorëve të të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe vajzave dhe dënimi i autorëve sipas rastit. Futja e masave që synojnë të ndihmojnë dhe të motivojnë autorët e dhunës për të ndërprerë ciklin e dhunës dhe marrja e masave që shpagojnë viktimat;

(c) Trajtimi si vepër penale, e dënueshme me ligj i të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe vajzave të të gjitha moshave, përfshirë dhunën që bazohet në të gjitha format e diskriminimit;

(d) Krijimi i legjislacionit dhe/ose forcimi i mekanizmave të përshtatshëm për të trajtuar çështjet penale në lidhje me të gjitha format e dhunës vendore, përfshirë përdhunimin martesor dhe dhunën seksuale të grave dhe vajzave, dhe garantimi që këto raste të çohen përpara drejtësisë menjëherë;

(e) Krijimi, adoptimi dhe zbatimi i plotë i ligjeve dhe masave të tjera, të tilla si politika dhe programe arsimore, për të çrrënjësuar praktikat zakonore ose tradicionale, përfshirë gjymtimin gjenital femëror, martesën e hershme dhe të detyruar dhe të ashtuquajturat krime për nder, që janë shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe intensifikimi i përpjekjeve, në bashkëpunim me grupet vendore të grave, për të ngritur ndërgjegjësimin kolektiv dhe individual mbi këto praktika tradicionale dhe zakonore që dhunojnë të drejtat e njeriut të grave;

(f) Të vazhdohen studimet kërkimore për të kuptuar më mirë shkaqet për të gjitha format e dhunës kundër grave në mënyrë që të hartohen programe dhe të merren masa për eliminimin e këtyre formave të dhunës;

(g) Të merren masa për të trajtuar përmes politikave dhe programeve, racizmin dhe dhunën me motive raciale kundër grave dhe vajzave;

(h) Të merren hapa konkretë, me pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe vullnetare për të trajtuar ndikimin e dhunës mbi gratë indigjene në mënyrë që të zbatohen programe dhe shërbime efektive për të eliminuar të gjitha format e dhunës;

(i) Të mbështetet mirëqenia e grave dhe vajzave, integrimi i shërbimeve të shëndetit mendor në sistemin e kujdesit shëndetësor parësor, të zhvillohen programe mbështetëse me orientim gjinor dhe të trajnohen punonjësit shëndetësor për të dalluar dhunën me bazë gjinore dhe për t'u kujdesur për gratë dhe vajzat e të gjitha moshave që kanë pësuar dhunë të çfarëdolloj forme;

(j) Adoptimi i një trajtimi tërësor të të gjitha formave të dhunës dhe të abuzimit kundër vajzave dhe grave të të gjitha moshave, përfshirë gratë dhe vajzat me paaftësi, si dhe gratë dhe vajzat e dobëta dhe të veçuara me qëllim trajtimin e nevojave të tyre të veçanta, dhënien e kujdesit dhe shërbimeve të përshtatshme shëndetësore dhe shërbimeve elementare shoqërore;

(k) Miratimi i një trajtimi tërësor për të luftuar dhunën kundër grave gjatë tërë ciklit dhe rrethanave të jetës së tyre.

70. (a) Marrja e masave të përshtatshme për trajtimin e faktorëve bazë, përfshirë faktorët e jashtëm, që inkurajojnë trafikimin e grave dhe të vajzave për prostitucion dhe forma të tjera të seksit tregtar, martesat e detyruara dhe punën e detyruar me qëllim eliminimin e trafikimit të grave, përfshirë forcimin e legjislacionit ekzistues për të dhënë mbrojtje më të mirë për të drejtat e grave dhe të vajzave dhe për dënimin e autorëve, përmes masave penale dhe civile;

(b) Hartimi, zbatimi dhe forcimi i masave efektive për të luftuar dhe eliminuar të gjitha format e trafikimit të grave dhe të vajzave përmes strategjive gjithëpërfshirëse kundër trafikimit, veç të tjerash, masat legjislative, fushatat parandaluese, shkëmbimi i informacionit, ndihma dhe mbrojtja e viktimave dhe ri-integrimi i tyre dhe ndjekja penale e të gjithë autorëve të këtij trafiku përfshirë edhe ndërmjetësit;

(c) Të shihet mundësia brenda kuadrit ligjor dhe në përputhje me politikat kombëtare, për parandalimin e ndjekjes penale në vendin e hyrjes ilegalisht ose në vendbanimin e tyre, të viktimave të trafikimit, veçnisht gratë dhe vajzat, për shkak se ato janë viktimat të shfrytëzimit;

(d) Të shihet mundësia për ngritjen ose forcimin e mekanizmit kombëtar për koordinimin, për shembull, të një raportuesi kombëtar ose një organi me përfaqësues nga disa agjenci, me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, përfshirë organizatat jo-qeveritare, për të inkurajuar shkëmbimin e informacionit dhe për të raportuar për të dhënat, shkaqet, faktorët dhe tendencat e dhunës kundër grave, në veçanti të trafikimit;

(e) Të mbrohen dhe të mbështeten gratë dhe familjet e tyre dhe të zhvillohen dhe forcohen politikat në mbrojtje të sigurisë së familjes së tyre;

71. (a) Të shihet mundësia për adoptimin, kur është e mundur, të legjislacionit kombëtar në përputhje me Konventën për Diversitetin Biologjik¹² në mbrojtje të dijeve, të novacioneve, dhe praktikave të grave në komunitetet e tyre indigjene dhe vendore në lidhje me mjekësinë tradicionale, biodiversitetin, dhe teknologjitë indigjene;

(b)Përshtatja e politikave dhe mekanizmave mjedisorë dhe agrikulorë, kur është e nevojshme, për të përfshirë një perspektivë gjinore, dhe në bashkëpunim me shoqërinë civile, të mbështesë fermerët, veçanërisht gratë fermere dhe ato që jetojnë në zona fshatare, me programe arsimimi dhe trajnimi.

72. (a)Përshtatja e politikave dhe zbatimi i masave për të trajtuar, mbi baza prioritare aspektet gjinore të sfidave shëndetësore të reja dhe ekzistuese, si malaria, tuberkulozi, HIV/AIDS dhe sëmundje të tjera që kanë ndikim më të madh mbi shëndetin e grave, përfshirë ato që rezultojnë në numër të lartë të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë amtare;

(b) Reduktimi i vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë të bëhet prioritet i sektorit shëndetësor dhe gratë të kenë qasje të menjëherëshme në kujdesin obstetrik, shërbimet e kujdesit shëndetësor amtar me pajisjet dhe personelin e duhur, të kenë ndihmën e duhur gjatë lindjes, të kenë shërbimin e duhur për urgjencat obstetrike, sistem efektiv referimi dhe transportimi për në nivele më të larta të kujdesit kur është e nevojshme, kujdes pas lindjes, dhe planifikimin familjar në mënyrë që të ndihmohet mëmësia e sigurt, dhe t'i jepet vëmendje prioritare masave për parandalimin, zbulimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit, cervikal dhe të ovarëve, osteoporozës dhe infeksioneve seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS;

(c) Të merren masa për të plotësuar nevojat për shërbime cilësore të planifikimit familjar dhe kontracepsionin, kryesisht në lidhje me hendekun ekzistues në shërbime, furnizim dhe përdorim;

(d) Të mblidhen dhe të shpërndahen të dhëna të freskëta dhe të besueshme për vdekshmërinë dhe sëmundshmërinë e grave dhe të bëhen studime të mëtejshme sesi faktorët socialë dhe ekonomikë ndikojnë shëndetin e grave dhe të vajzave të të gjitha moshave, si dhe punë kërkimore për dhënien e shërbimeve të kujdesit shëndetësor grave dhe vajzave, për modelet e përdorimit të këtyre shërbimeve dhe për vlerën e programeve të edukimit shëndetësor dhe parandaluese për gratë;

(e) Të sigurohet qasje universale dhe e njëjtë për gratë dhe burrat gjatë tërë jetës së tyre, në shërbimet sociale që lidhen me kujdesin shëndetësor, përfshirë arsimin, ujin e pastër dhe higjienën, ushqyerjen, sigurimin e ushqimit dhe programet e edukimit shëndetësor;

(f) Të garantohet krijimi i kushteve të sigurta të punës për punonjësit e shëndetësisë;

(g) Të adoptohet, futet në fuqi, rishikohet, dhe të zbatohet legjislacioni, politikat dhe programet shëndetësore, duke u konsultuar me organizatat e grave dhe aktorët e tjerë të shoqërisë civile

¹² Shih Programin e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin, *Konventa për Diversitetin Biologjik* (Ligji për Mjedisin dhe Qendra për Aktivitetet e Programit e Institutit), qershor 1992.

dhe të vihen në dispozicion burimet e nevojshme buxhetore për garantimin e standardit më të lartë të mundshëm për shëndetin fizik dhe mendor, në mënyrë që gratë të kenë qasje të plotë dhe të barabartë në tërë kujdesin shëndetësor, informacionin, edukimin dhe shërbimet gjatë tërë jetës së tyre; të reflektohen kërkesat e reja të grave dhe vajzave për shërbime dhe kujdes, që rezultojnë nga pandemia e HIV/AIDS dhe njohuritë e reja për nevojat e grave për programe të reja të shëndetit mendor dhe të punësimit si dhe për procesin e moshimit; të mbrohen dhe të çohen përpara të drejtat e njeriut përmes garantimit që të gjitha shërbimet dhe punonjësit shëndetësor janë konform standardeve etike, profesionale dhe gjinore gjatë dhënies së kujdesit shëndetësor, përfshirë krijimin ose forcimin e mekanizmave rregullator dhe zbatues.

(h) Të zhduket diskriminimi kundër të gjitha grave dhe vajzave gjatë qasjes së tyre në informacionin, edukimin dhe kujdesin dhe shërbimet shëndetësore;

(i) Shëndeti riprodhues është një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe shoqërore, dhe jo thjesht mungesë e sëmundjes, në të gjitha çshtjet që lidhen me sistemin riprodhues dhe funksionet dhe proceset e saj. Shëndeti riprodhues nënkupton që njerëzit të jenë në gjendje që të kenë jetë seksuale të kënaqshme dhe të sigurt dhe që ata të jenë në gjendje të riprodhohen dhe të kenë lirinë që të vendosin vetë nëse, kur dhe sa herë të riprodhohen. E rëndësishme për këtë të fundit, është e drejta e burrave dhe grave që të kenë qasje në metodat e sigurta, të efekshme, të përbalueshme dhe të pranueshme të planifikimit familjar si dhe në metoda të tjera që ata dëshirojnë të zgjedhin në përputhje me ligjin, për rregullimin e fertilitetit, dhe e drejta për qasje në shërbimet e përshtatshme të kujdesit shëndetësor që do t'u mundësonte grave që të kenë shtatzëni dhe lindje të sigurt dhe do t'u jepte çifteve shanset më të mira për të pasur fëmijë të shëndetshëm. Në të njëjtën linjë me përkufizimin e shëndetit riprodhues, përcaktohet edhe kujdesi për shëndetin riprodhues si seri metodash, teknikash dhe shërbimesh që kontribuojnë për shëndetin riprodhues dhe mirëqenien përmes parandalimit dhe zgjidhjes së problemeve të shëndetit riprodhues. Kjo përfshin edhe shëndetin seksual, qëllimi i të cilit është zgjerimi i marrëdhënieve jetësore dhe personale, dhe jo thjesht këshillimi dhe kujdesi që lidhen me riprodhimin dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme;

(j) Mbështetur në përkufizimin e mësipërm, të drejtat riprodhuese përfshijnë disa të drejta njerëzore që njihen nga ligjet kombëtare, dokumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe nga dokumente të tjera konsensuale. Këto të drejta bazohen në njohjen e të drejtave bazë të të gjitha çifteve dhe individëve për të vendosur lirisht dhe me përgjegjësi numrin, distancën dhe kohën e lindjeve të fëmijëve të tyre, dhe të kenë informacionin dhe mjetet për ta bërë këtë, dhe të drejtën për të pasur standardin më të lartë të shëndetit seksual dhe atij riprodhues. Ato përfshijnë edhe të drejtën për të marrë vendime në lidhje me riprodhimin pa diskriminim, detyrim, dhe dhunë, si shprehet në dokumentet e të drejtave të njeriut. Gjatë ushtrimit të këtyre të drejtave, ata duhet të marrin parasysh nevojat e fëmijëve të tyre dhe përgjegjësitë e tyre ndaj komunitetit. Ushtrimi me përgjegjësi i këtyre të drejtave për të gjithë njerëzit duhet të jetë baza themelore për politikat dhe programet qeveritare dhe komunitare në fushën e shëndetit riprodhues dhe të planifikimit familjar. Si pjesë e angazhimit të tyre, duhet t'i kushtohet vëmendje marrëdhënieve gjinore të barabarta dhe respektuese dhe veçnaërisht plotësimin të nevojave për edukim dhe shërbime të adoleshentëve për t'i bërë ata të aftë që të manaxhojnë seksualitetin e tyre pozitivisht dhe me përgjegjësi. Shëndeti riprodhues nuk kapet nga shumë

njerëz në botë për shkak të nivelit të ulët të dijeve për seksualitetin e njeriut, dhe informacionit dhe shërbimeve jo cilësore të shëndetit riprodhues; Prevalenca e sjelljeve të rrezikshme seksuale, e praktikave diskriminuese, qëndrimeve negative ndaj grave dhe vajzave; dhe e fuqisë së kufizuar që shumë gra dhe vajza kanë ndaj jetëve të tyre seksuale dhe riprodhuese. Në shumicën e vendeve, adoleshentet janë veçanërisht të rrezikuara nga mungesa e informacionit dhe qasjes në shërbimet përkatëse. Gratë dhe burrat e moshuar kanë nevojë të caktuara shëndetit seksual dhe riprodhues të cilat trajtohen në mënyrë të papërshtatshme;

(k) Të drejtat e njeriut të grave përfshijnë të drejtën e tyre për të kontrolluar dhe vendosur lirisht dhe me përgjegjësi, pa detyrim, diskriminim apo dhunë, për seksualitetin, përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues. Marrëdhëniet e barabarta ndërmjet burrave dhe grave në lidhje me seksualitetin dhe riprodhimin, përfshirë respektin e plotë për integritetin e personit, kërkojnë respekt reciprok, përgjegjësi të përbashkët për sjelljen seksuale dhe pasojat e saj;

(l)Hartimi dhe zbatimi i programeve për inkurajimin dhe aftësimin e burrave për të adoptuar sjellje seksuale dhe riprodhuese të sigurta dhe të përgjegjshme, dhe për të përdorur metoda efektive për parandalimin e shtatzënive të padëshiruara dhe infeksioneve seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS;

(m) Marrja e të gjitha masave për të zhdukur ndërhyrjet e rrezikshme, të panevojshme, të detyruara si dhe mjekimin dhe mjekimin e tepruar të grave, dhe garantimi që gratë janë të informuara nga personel i trajnuar për zgjedhjet e tyre, përfshirë përfitimet dhe efektet anësore të mundshme;

(n) Marrja e masave për të garantuar mos-diskriminimin dhe fshehtësinë e informacionit për ata që jetojnë me HIV/AIDS dhe infeksione seksualisht të transmetueshme, përfshirë gratë dhe të rinjtë, që mënyrë që të mos u mohohet informacioni për të parandaluar transmetimin e mëtejshëm të

HIV/AIDS dhe të sëmundjeve të tjera seksualisht të transmetueshme dhe të jenë në gjendje që të kenë qasje në shërbimet që trajtojnë dhe kujdesen për këto sëmundje, pa frikë nga stigmatizimi ose dhuna;

(o) Në dritën e paragrafit 8.25 të Programit të Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin, që thotë:

“Në asnjë rast aborti nuk duhet të paraqitet si metodë e planifikimit familjar. Të gjitha qeverive, dhe organizatave ndërqeveritare dhe jo-qeveritare u kërkohet që të forcojnë angazhimin e tyre për shëndetin e grave për të trajtuar ndikimin shëndetësor të abortit të pasigurt²⁰ si një shqetësim për shëndetin publik dhe për të pakësuar përdorimin e abortit përmes shërbimeve të zgjeruara dhe të përmirësuara të planifikimit familjar.

Parandalimit të shtatzënive të padëshiruara duhet t'i jepet përparësi e lartë dhe duhet bërë çdo përpjekje për të zhdukur nevojën për abort. Gratë që kanë shtatzëni të padëshiruara duhet të kenë qasje të menjëhershme në informacionin dhe këshillimin e besueshëm. çdo masë ose ndryshim që lidhet me abortin në sistemin shëndetësor duhet të vendoset në nivel kombëtar dhe vendor sipas procesit kombëtar legjislativ. Në rrethana ku aborti nuk është i kundërligjshëm, aborti duhet të jetë i sigurt. Në të gjitha rastet gratë duhet të kenë qasje në shërbime cilësore për manaxhimin e ndërlikimeve nga

aborti. Këshillimi pas abortit, edukimi dhe shërbimet e planifikimit familjar duhet të ofrohen menjëherë, çka do të evitonte përsëritjen e aborteve. Të konsiderohet rishikimi i ligjeve që përmbajnë masa ndëshkimore kundër grave që bëjnë abort të paligjshëm.

“20 Aborti i pasigurt përkufizohet si një procedurë për ndërprerjen e shtatzënisë së padëshiruar ose nga personaa që nuk kanë shprehitë e nevojshme ose në një mjedis që nuk ka standardet minimale mjekësore ose të dyja këto (bazuar në Parandalimi dhe Manaxhimi i Abortit të Pasigurt, i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Raporti i Grupit Teknik të Punës, Gjenevë, Prill 1992 (ËHO/MSM/92.5))”,

(p) Promovimi dhe përmirësimi i parandalimit me perspektivë gjinore, të duhanit dhe strategjive të kontrollit për të gjitha gratë, veçanërisht për vajzat adoleshente dhe gratë shtatzëna, që do të përfshinte edukimin, parandalimin dhe ndërprerjen e programeve dhe të shërbimeve, reduktimin e ekspozimit të njerëzve ndaj tymit të duhanit, dhe mbështetje për zhvillimin e kuadrit ndërkombëtar për kontrollin e duhanit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë;

(q) Promovimi ose përmirësimi i programeve dhe masave informuese përfshirë trajtimin për zhdukjen e abuzimit me substancat nga gratë dhe vajzat, përfshirë fushatat informuese për rreziqet shëndetësore dhe pasojat e tyre mbi familjet.

73. (a) Futja e perspektivës gjinore në politikat për zhvillimin makroekonomik dhe social dhe programet kombëtare të zhvillimit;

(b) përfshirja e perspektivës gjinore në hartimin, zhvillimin, adoptimin dhe ekzekutimin e të gjitha proceseve buxhetore, në mënyrë që të nxitet shpërndarja e barabartë, efektive dhe e përshtatshme e burimeve dhe të caktohen burimet e përshtatshme buxhetore në mbështetje të barazisë gjinore dhe programeve të zhvillimit që nxisin fuqizimin e grave dhe zhvillimin e instrumenteve të nevojshme analitike dhe metodologjike dhe mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin;

(c) Rritja, dhe përdorimi efektiv i burimeve financiare në sektorin shoqëror, veçanërisht në arsim dhe shëndetësi, për të arritur barazi gjinore dhe fuqizimin e grave si një strategji qëndrore për zhvillim dhe zhdukjen e varfërisë;

(d) Përpjekjet për të ulur numrin e pabarabartë të grave që jetojnë në varfëri, në veçanti të grave të fshatit, përmes zbatimit të programeve kombëtare për çrrënjosjen e varfërisë me fokus në perspektivën gjinore dhe në fuqizimin e grave, përfshirë synimet afatgjatë dhe afatshkurtëra.

74. (a) Hartimi i politikave social-ekonomike që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbështesin çrrënjosjen e varfërisë, veçanërisht për gratë, përmes trajnimit, qasjes dhe kontrollit të barabartë të burimeve, financave, kreditit dhe mikrokreditit, informacionit dhe teknologjisë dhe qasjes së njëjtë tek tregu të grave të të gjitha moshave, në veçanti atyre që jetojnë në varfëri, dhe janë të veçuara nga shoqëria, përfshirë gratë fshatare, indigjene dhe familjet që drejtohen nga gratë;

(b)Garantimi i qasjs në sistemet e mbrojtjes sociale, duke marrë parasysh nevojat specifike të të gjitha grave që jetojnë në varfëri, në ndryshime demografike dhe shoqërore, për të ofruar mbrojtje kundër pasigurisë dhe ndryshimeve të kushteve të punës që shoqërohen nga globalizimi, dhe përpjekja për të siguruar që forma të reja, fleksible, të punës të mbuloen nga mbrojtja e duhur sociale;

(c) Rishikimi, modifikimi dhe zbatimi i vazhdueshëm i politikave dhe programeve makroekonomike dhe shoqërore, përmes analizës nga pikëpamja gjinore e politikave që lidhen me probleme të rregullimit strukturor dhe të borxhit të jashtëm, në mënyrë që të garantohet qasja e barabartë e grave në burimet dhe shërbimet bazë shoqërore.

75. Lehtësimi i punësimit për gratë përmes mbrojtjes sociale, thjeshtimit të procedurave administrative, heqjes së pengesave fiskale, si dhe përmes masave të tjera si qasja tek kapitali, skemat e kreditit, mikrokreditit, dhe financime të tjera, ngritja e mikrondërmarrjeve dhe e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

76. (a) Ngritja ose forcimi i mekanizmave institucionalë ekzistues në të gjitha nivelet për të punuar me makineritë kombëtare për forcimin e mbështetjes shoqërore për barazinë gjinore, në bashkëpunim me shoqërinë civile, veçanërisht me organizatat jo-qeveritare të grave;

(b)Marrja e masave në nivelet më të larta për përparimin e vazhdueshëm të grave, në veçanti përmes forcimit të makinerive kombëtare për përfshirjen e perspektivës gjinore me qëllim përshpejtimin e fuqizimit të grave në të gjitha fushat dhe garantimin e angazhimit në politikat e barazisë gjinore;

(c) Pajisja e makinerive kombëtare me burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare, përfshirë studimin e skemave të reja të financimit, në mënyrë që perspektiva gjinore të integrohet në të gjitha politikat, programet dhe projektet;

(d) Të shihet mundësia për ngritjen e komisioneve apo institucioneve të tjera efektive për të nxitur shanset e barabarta;

(e) Forcimi i përpjekjeve për zbatimin e planeve kombëtare të veprimit të hartuara në zbatim të Platformës për Veprim të Beijing, dhe kur është e nevojshme të përshtaten ose të hartohen plane kombëtare për të ardhmen;

(f) Të garantohet që hartimi i të gjitha politikave dhe strategjive qeveritare informuese të ketë perspektivë gjinore.

77. (a) Zyrrave kombëtare të statistikës t'u jepet mbështetje institucionale dhe financiare në mënyrë që ato të mbledhin, hartojnë dhe shpërndajnë të dhëna të zbërthyera sipas seksit, moshës dhe faktorëve të tjerë, në formate që mund të përdoren nga publiku dhe nga politikëbërësit për analizën me bazë gjinore, monitorimin, dhe vlerësimin e ndikimit, dhe për hartimin e statistikave dhe indikatorëve të rinj, në fusha ku informacioni mungon;

(b) Hartimi dhe publikimi i rregullt i statistikave të krimit, dhe monitorimi i tendencave në zbatimin e ligjit në lidhje me shkeljet e të drejtave të grave dhe të vajzave për të rritur ndërgjegjësimin për hartimin e politikave më efektive;

(c) Zhvillimi i kapacitetit kombëtar për të kryer studime me orientim gjinor dhe politik dhe përdorimi i studimeve të kryera nga universitetet dhe institucionet kombëtare kërkimore për politikë-bërjen me orientim gjinor dhe të mbështetur në dije.

B. Masa të tjera që duhen marrë në nivel kombëtar nga qeveritë, sektori privat, organizatat jo-qeveritare dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile:

78. (a) Të inkurajohen programet për trajnimin dhe kulturën ligjore në mbështetje të kapaciteteve të organizatave të grave, dhe në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të grave dhe të vajzave;

(b) Të nxitet bashkëpunimi, ndërmjet qeverive, organizatave joqeveritare, organizatave me bazë në komunitet, dhe drejtuesve tradicionalë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të grave dhe vajzave, të dinjitetit dhe vlerës së personit dhe të të drejtave të barabarta për gratë dhe burrat;

(c) Të inkurajohet bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve qeveritare, parlamentarëve dhe autoriteteve të tjera përkatëse dhe organizatave të grave, përfshirë organizatat jo-qeveritare, për garantimin e një legjislacioni jo-diskriminues;

(d) Të përfshihen në trajnime me orientim gjinor të gjithë aktorët, përfshirë policët, prokurorët, dhe gjykatësit, për trajtimin e viktimave të dhunës, veçanërisht të grave dhe të vajzave, përfshirë dhunën seksuale.

79. (a) Adoptimi i një trajtimi tërësor të shëndetit fizik dhe mendor të grave gjatë tërë jetës së tyre, marrja e masave të mëtejshme për riformulimin e informacionit, shërbimeve dhe trajnimit për punonjësit shëndetësorë për t'i bërë ata të kujdesshëm ndaj gjinisë, për të nxitur balancën gjinore në të gjitha nivelet e sistemit të kujdesit shëndetësor, dhe për të reflektuar perspektivën e grave dhe të drejtën e tyre për fshehtësi, konfidencialitet, miratim vullnetar dhe të informuar;

(b) Forcimi i përpjekjeve për të garantuar qasje universale në kujdesin shëndetësor cilësor gjatë tërë jetës së tyre, përfshirë kujdesin shëndetësor seksual dhe riprodhues, jo më vonë se 2015;

(c) Rishikimi i politikave, programeve dhe i legjislacionit kombëtar për të zbatuar veprimet kryesore në zbatim të Programit të Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin të adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme në sesionin e vet të njëzetë e një, duke i kushtuar vëmendje të veçantë arritjes së objektivave specifike për uljen e vdekshmërisë amtare, rritjen e numrit të lindjeve të pritura nga persona të aftë për këtë, dhënien e një game të gjërë metodash të efektshme dhe të sigurta të planifikimit familjar dhe të kontracepsionit dhe për pakësimin e rrezikut për HIV/AIDS për të rinjtë;

(d) Forcimi i masave për përmirësimin e statusit të ushqyerjes për të gjitha gratë dhe vajzat, duke njohur efektet e të kequshyerit, pasojat afatgjata të ushqyerjes dhe lidhjen mes shëndetit të nënës dhe të fëmijës, duke mbështetur programet për pakësimin e kequshqyerjes, si programet për dhënien e vakteve në shkolla, programet për ushqyerjen e nënës dhe fëmijës dhe suplementimin mikronutrient, duke pasur në vëmendje ngushtimin e hendekut gjinor në ushqyerje;

(e) Rishikimi me pjesëmarrjen e plotë të grave dhe monitorimi i ndikimit të reformës në sektorin shëndetësor mbi shëndetin e grave dhe gëzimin nga ana e tyre të të drejtave të njeriut, në veçanti në lidhje me shërbimet shëndetësore për gratë e varfëra të fshatit dhe të qytetit, dhe sigurimi që reformat të sjellin qasje të plotë dhe të barabartë në kujdesin shëndetësor të përballeshëm dhe cilësor për të gjitha gratë, dhe për nevojat e tyre të ndryshme;

(f) Hartimi dhe zbatimi, me përfshirjen e adoleshentëve, i programeve për edukim, informim dhe dhënia e shërbimeve specifike, të hapura dhe miqësore, pa diskriminim, për të trajtuar nevojat e tyre riprodhuese dhe seksuale, duke marrë në konsideratë të drejtën e tyre për fshehtësi, konfidencialitet, respekt dhe miratim të informuar, dhe përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e prindërve dhe kujdestarve ligjorë për t'i orientuar dhe për t'iu dhënë direktiva në përputhje me zhvillimin e fëmijës gjatë ushtrimit nga ana e fëmijës të të drejtave të njohura nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës¹³ në përputhje me Konventën për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave dhe për të garantuar se në të gjitha veprimet që lidhen me fëmijët, i jepet përparësi interesave të fëmijës. Këto programe duhet të rrisin vetë-vlerësimin e adoleshentëve dhe t'i ndihmojnë ata që të marrin përgjegjësi për jetët e tyre; të nxisin barazinë gjinore dhe sjelljen seksuale të përgjegjshme; të rrisin ndërgjegjësimin për parandalimin dhe trajtimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS, dhe dhunën dhe abuzimin seksual; dhe këshillimi i adoleshentëve për të shmangur shtatzënitë e padëshiruara dhe të hershme;

(g) Të hartohen dhe zbatohen programe për shërbime sociale dhe për të mbështetur adoleshentet shtatzëna dhe adoleshentet nëna, në veçanti për tu mundësuar atyre që të vazhdojnë dhe të mbarojnë shkollimin e tyre;

(h) T'i kushtohet vëmendje e posaçme zhvillimit dhe qasjes në teknologjitë e reja dhe në ilaçet e padëmshme dhe me kosto të përballeshme dhe trajtimit të sëmundjeve për të plotësuar nevojat e grave, përfshirë sëmundjet kardipulmonare, hipertensionin, osteoporozën, kancerin e gjirit, të cerviksit dhe të ovareve dhe metodat e planifikimit familjar për gratë dhe burrat.

80. Krijimi dhe përdorimi i udhëzuesve, instrumentëve dhe indikatorëve praktikë për të përshpejtuar përfshirjen e perspektivës gjinore, në kërkimet me bazë gjinore, në instrumentet dhe metodologjitë analitike, trajnimin, studimet e rastit, statistikat dhe informacionin.

81. (a) Ofrimi i shanseve të barabarta dhe kushteve favorizuese për gratë e të gjitha moshave dhe formimeve, në kushte të barabarta me burrat duke inkurajuar futjen e tyre në politikë dhe pjesëmarrjen e tyre në të gjitha nivelet;

¹³ Rezoluta 44/25, aneksi

(b) Inkurajimi i caktimit të sa më shumë grave kandidate, përmes partive politike, kuotave ose mjeteve të tjera të matshme për zgjedhje në parlament, dhe struktura të tjera legjislative për të rritur kontributin e tyre në formulimin e politikave publike;

(c) Krijimi dhe mbajtja e proceseve dhe mekanizmave konsultativë, në partneritet me organizatat e grave, përfshirë organizatat jo-qeveritare dhe komunitetet për të garantuar që të gjitha gratë e veçanërisht ato që kanë pengesa për pjesëmarrjen në jetën publike, të përfshihen plotësisht dhe të jenë të informuara për vendimet që ndikojnë jetët e tyre.

82. (a) Mbrojtja e të drejtave të grave punëtore dhe marrja e masave për heqjen e pengesave strukturore dhe ligjore si dhe e qëndrimeve stereotipike ndaj barazisë gjinore në punë, trajtimi i anshmërive gjinore në punësim; kushtet e punës; diskriminimi në përfitimet e kujdesit shoqëror; shëndeti dhe siguria shëndetësore e grave në punë; mundësitë e pabarabarta në karrierë dhe ndarja e pabarabartë me burrat, e përgjegjësive në familje;

(b) Promovimi i programeve për aftësimin e grave dhe të burrave që të gjejnë balancën midis punës dhe përgjegjësive në familje dhe për t'i inkurajuar burrat që të ndajnë në mënyrë të barabartë me gratë përgjegjësitë ndaj shtëpisë dhe familjes;

(c) Zhvillimi dhe forcimi i politikave dhe programeve në mbështetje roleve të shumta të grave për mirëqënien e familjes në format e veta të ndryshme. Këto politika dhe programe pranojnë domethënien shoqërore të shtatzënisë dhe mëmësisë, prindësisë, rolit të prindërve dhe të kujdestarëve ligjorë në rritjen e fëmijëve dhe kujdesin për anëtarët e tjerë të familjes. Ato duhet të nxisin edhe ndarjen e përgjegjësive mes prindërve, grave dhe burrave në shoqëri në përgjithësi;

(d) Hartimi, zbatimi dhe mbështetja e politikave dhe shërbimeve mik-i- familjes, duke përfshirë shërbime të përbalueshme, të hapura dhe cilësore për fëmijët, skema për leje për prindërit dhe fushata për të rritur ndjeshmërinë e publikut për ndarjen e barabartë të punësimit dhe të përgjegjësive në familje të grave dhe të burrave;

(e) Hartimi i politikave dhe programeve për të rritur punësueshmërinë e grave dhe qasjen e tyre në punë cilësore, përmes përmirësimit të përfshirjes së tyre në trajnimin zyrtar, jo-zyrtar dhe profesional, mësimin dhe ri-trajnimin gjatë tërë jetës, edukimit në distancë, përfshirë edhe teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të mbështetur fuqizimin e grave në fazat e ndryshme të jetës së tyre;

(f) Marrja e masave për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe për të sjellë një përfaqësim të balancuar të grave dhe të burrave në të gjithë sektorët dhe profesionet në tregun e punës, duke inkurajuar krijimin ose zgjerimin e rrjeteve institucionale për të mbështetur zhvillimin e karrierës dhe ecjen përpara të grave;

(g) Krijimi dhe/ose forcimi i programeve dhe politikave në mbështetje të grave në biznes, përfshirë ato që përfshihen në biznese të reja, përmes qasjes në informacion, trajnim, përfshirë trajnimin profesional, teknologjitë e reja, shërbimet e kreditit dhe ato financiare;

(h) Marrja e hapave pozitive për të nxitur pagesën e barabartë për punë të barabartë ose për punë me vlerë të barabartë dhe për pakësimin e ndryshimeve në të ardhurat ndërmjet grave dhe burrave;

(i) Inkurajimi dhe mbështetja e arsimimit të vajzave në shkencë, matematikë, teknologjitë e reja, përfshirë teknologjitë e informacionit, dhe lëndët teknike, dhe inkurajimi i grave përmes këshillimit për karrierë, të kërkojnë punësim në sektorët me rritje më të madhe dhe me pagesa më të mëdha;

(j) Hartimi i politikave dhe zbatimi i programeve, veçanërisht për burrat dhe djemtë, për ndryshimin e qëndrimeve stereotipike dhe të sjelljeve që lidhen me rolet dhe përgjegjësitë gjinore për nxitjen e barazisë gjinore dhe të qëndrimeve dhe sjelljeve pozitive;

(k) Forcimi i fushatave për ndërgjegjësimin gjinor, dhe trajnimi për barazinë gjinore mes grave dhe burrave, vajzave dhe djemve për eliminimin e stereotipeve të dëmshëm;

(l) Analizimi dhe përgjigja sipas nevojës arsyeve kryesore pse burrat dhe gratë ndikohen ndryshe nga procesi i krijimit të vendeve të punës dhe pakësimin e tyre në ekonomitë në tranzicion dhe ato në transformim strukturor, përfshirë globalizimin;

(m) Nxitja e ndjeshmërisë gjinore dhe e përgjegjësisë shoqërore të sektorit privat, përmes manaxhimit të kohës së punës dhe shpërndarjes së informacionit me ndjeshmëri gjinore dhe fushatave sensibilizuese.

83. (a) Forcimi ose krijimi, i mekanizmave kombëtarë të bashkëpunimit dhe të raportimit të rregullt, me pjesëmarrjen e organizatave jo-qeveritare, veçanërisht organizatave të grave, për të monitoruar progresin në zbatimin e politikave, programeve dhe objektivave për arritjen e barazisë gjinore;

(b) Mbështetja e punës së organizatave jo-qeveritare dhe organizatave me bazë komunitetin që janë në ndihmë të grave të privuara, në veçanti atyre fshatare për të pasur qasje në institucionet financiare gjatë krijimit të biznesit dhe mjeteve të tjera të qëndrueshme të jetesës;

(c) Marrja e masave për të aftësuar gratë e moshuara që të përfshihen aktivisht në të gjitha aspektet e jetës, si dhe për të marrë një sërë rolesh në komunitet, jetën publike dhe vendim-marrje, dhe për të zhvilluar dhe zbatuar politikat dhe programet për garantimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë së jetës, si dhe për të trajtuar nevojat e tyre, me synim realizimin e një shoqërie për të gjitha moshat;

(d) hartimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve për të trajtuar nevojat specifike të grave dhe vajzave me paaftësi, për të garantuar qasje të barabartë në arsimin e të gjitha niveleve, përfshirë atë teknik dhe profesional, dhe në programet e riaftësimit, shërbimet shëndetësore dhe shanset e punësimit, për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe për zhdukur pabarazitë ekzistuese ndërmjet grave dhe burrave me paaftësi.

C. Veprime që duhen marrë në nivel ndërkombëtar nga sistemi i Kombeve të Bashkuar dhe organizatat ndërkombëtare dhe rajonale sipas rastit:

84. (a) Të ndihmohen qeveritë, sipas kërkesës së tyre, për të ndërtuar kapacitete institucionale dhe për të zhvilluar plane veprimi kombëtare ose për zbatimin e mëtejshëm të planeve ekzistuese në zbatim të Platformës së Veprimit;

(b) Të mbështeten organizatat jo-qeveritare, veçanërisht ato të grave, për të ndërtuar kapacitete për të mbështetur, zbatuar, vlersuar dhe ndjekur Platformën për Veprim;

(c) Venia në dispozicion e burimeve të mjaftueshme për programet rajonale dhe kombëtare për të zbatuar Platformën për Veprim në të dymbëdhjetë fushat e saj kryesore të shqetësimit;

(d) Të ndihmohen qeveritë në vendet me ekonomi në tranzicion që të hartojnë dhe zhvillojnë më tej planet dhe programet që synojnë fuqizimin ekonomik dhe politik të grave;

(e) Inkurajimi i Këshillit Ekonomik dhe Social për të kërkuar komisione rajonale, brenda mandateve dhe burimeve të tyre, për të ndërtuar një bazë të dhënash që duhet të freskohet rregullisht, në të cilin regjistrohen të gjitha programet dhe projektet në rajonet respektive sipas agjencive dhe organizatave të sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe për të lehtësuar shpërndarjen e tyre si dhe vlerësimin e ndikimit të tyre për fuqizimin e grave përmes zbatimit të Platformës për Veprim.

85. (a) të vazhdohet zbatimi, vlerësimi dhe ndjekja e punës së mandatuar për agjencitë e Kombeve të Bashkuara, duke përfutur nga ekspertiza e sistemit të Kombeve të Bashkuara, si dhe nga përfundimet e Këshillit Ekonomik dhe Social dhe programe e nisma të tjera për përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha politikat, programet dhe planifikimin e sistemit të Kombeve të Bashkuar, përmes ndjekjes së integruar dhe të koordinuar të të gjitha konferencave dhe takimeve të nivelit të lartë si dhe për të siguruar caktimin e burimeve të mjaftueshme dhe mbajtjen e njësive gjinore dhe pikave fokale;

(b) Të ndihmohen vendet, sipas kërkesës së tyre, që të zhvillojnë metoda dhe të hartojnë statistika për kontributin e grave dhe të burrave në shoqëri dhe ekonomi, dhe për situatën social ekonomike të grave dhe të burrave, në veçanti në lidhje me varfërinë dhe punën e paguar dhe të papaguar në të gjithë sektorët;

(c) Të mbështeten përpjekjet kombëtare, veçanërisht në vendet në zhvillim për qasje më të madhe në teknologjinë informative si pjesë e përpjekjeve për të zhvilluar punë kërkimore, trajnim dhe shpërndarje të informacionit përfshirë edhe përmes Sistemit për Ndërgjegjësim Gjinor dhe Rrjetet të ngritur nga Instituti Ndërkombëtar për Kërkime dhe Trajnim për Përparimin e Grave, duke mbështetur në të njëjtën kohë metodat tradicionale të shpërndarjes së informacionit, kërkimit dhe trajnimit;

(d) Të garantohet që i gjithë personeli i Kombeve të Bashkuara dhe zyrtarët në Zyrat Qëndrore dhe në terren, veçanërisht ata me aktivitete në terren të trajnohen për përfshirjen e perspektivës

gjinore në punën e tyre, përfshirë analizën e ndikimit gjinor, dhe të sigurohet vazhdimësia e këtyre trajnimeve;

(e) Të mbështetet Komisioni për Statusin e Grave, në mandatit e tij, për vlerësimin dhe çuarjen përpara të zbatimit të Platformës së Beijing për Veprim dhe vazhdimësinë e saj;

(f) Të ndihmohen qeveritë, sipas kërkesës së tyre, në përfshirjen e perspektivës gjinore si një dimension i zhvillimit në planifikimin kombëtar të zhvillimit;

(g) Të ndihmohen Shtetet palë, sipas kërkesës së tyre, për të ngritur kapacitetet për zbatimin e Konventës për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, dhe të inkurajohen Shtetet palë për t'i kushtuar vëmendje komentet përmbyllëse si dhe rekomandimeve të përgjithshme të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave;

86. (a) Të ndihmohen qeveritë, sipas kërkesës së tyre, për zhvillimin e strategjive për dhënien e ndihmës, dhe kur është e nevojshme, për t'iu përgjigjur krizave humanitare që vijnë nga konfliktet e armatosur dhe fatkeqësitë e natyrës;

(b) Të garantohet pjesëmarrja e plotë e grave në të gjitha nivelet e vendim-marrjes dhe zbatimit të aktiviteteve për zhvillim dhe proceseve për paqe, përfshirë parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit, rindërtimin pas konfliktit, arritjen e paqes, dhe ndërtimin e paqes, dhe në lidhje me këtë, të mbështetet përfshirja e organizatave të grave, organizatave me bazë komunitetin dhe organizatat jo-qeveritare;

(c) Të inkurajohet përfshirja e grave në vendim-marrje të të gjitha niveleve dhe të arrihet balanca gjinore në emërimin e burrave dhe grave, në respekt të plotë të parimit të shpërndarjes së barabartë gjeografike, përfshirë, si të dërguara të posaçme dhe përfaqësuese speciale dhe në zyra të rëndësishme në emër të Sekretarit të Përgjithshëm, veç të tjerash, për çështje që lidhen me arritjen e paqes, ndërtimin e paqes dhe aktivitetet operationale që përfshijnë edhe koordinatorët rezidentë;

(d) Të ofrohen trajnime me ndjeshmëri gjinore për të gjithë aktorët, në misione paqeruajtëse që merren me viktimat, veçanërisht me gra dhe vajza, të dhunuara përfshirë të dhunura seksualisht;

(e) Të merren masa të mëtejshme efektive për të larguar pengesat në realizimin e të drejtës së njerëzve për vetë-vendosje, në veçnatit të njerëzve që jetojnë nën pushtimin colonial dhe të huaj, që vazhdojnë të ndikojnë negativisht mbi zhvillimin ekonomik dhe social;

87. (a) të mbështeten aktivitetet që synojnë zhdukjen e të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe vajzave, përfshirë mbështetjen për aktivitetet e rrjeteve dhe organizatave të grave brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara;

(b) Të shihet mundësia për fillimin e një fushate ndërkombëtare “tolerancë zero” dhunës kundër grave.

88. Të inkurajohet zbatimi i masave të hartuara për arritjen e qëllimit për balancë gjinore 50/50 në të gjitha postet, përfshirë nivelin profesional dhe në veçanti në nivele më të larta, në sekretariate, përfshirë misionet paqeruajtëse, negociatorët e paqes dhe në forcimin e manaxhimit të mekanizmave të llogaridhënies.

89. Të merren masa, me pjesëmarrjen e plotë të grave, për të krijuar, në të gjitha nivelet, një mjedis favorizues për arritjen dhe mbajtjen e paqes botërore, për demokracinë dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve, në respekt të plotë për parimet e sovranitetit, integritetit territorial dhe pavarësisë politike të Shteteve dhe të mos-ndërhyrjes në çështje që janë themelore brenda juridiksionit të Shtetit, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe ligjin ndërkombëtar, si dhe mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për zhvillim, dhe liritë themelore.

D.Masat që duhen marrë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nga Qeveritë, organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, përfshirë sistemin e Kombeve të Bashkuara, dhe institucionet ndërkombëtare financiare dhe aktorët e tjerë, sipas rastit:

90. Të merren hapa me qëllim evitimin e masave të njëanëshme në mospërputhje me ligjin ndërkombëtar dhe Kartën e Kombeve të Bashkuara që pengojnë arritjen e plotë të zhvillimit ekonomik dhe social të popullsisë të vendeve të ndikuara prej tyre, në veçanti të grave dhe të fëmijëve, dhe që rrezikojnë mirëqënien e tyre dhe krijojnë pengesa për gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën e gjithsecilit për një standard jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij dhe të drejtën e tyre për ushqim, kujdes mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale. Të garantohet që ushqimi dhe mjekimi të mos përdoren si mjete për presion politik.

91. Të merren masa urgjente dhe efektive në përputhje me ligjin ndërkombëtar me qëllim lehtësimin e ndikimit negativ të sanksioneve ekonomike mbi gratë dhe fëmijët.

92. (a) Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar në mbështetje të përpjekjeve rajonale dhe kombëtare për zhvillimin dhe përdorimin e analizës dhe statistikave për çështjet gjinore. Kjo duhet të bëhet mes të tjerash, përmes mbështetjes institucionale dhe financiare të zyrave të statistikës kombëtare me qëllim që, ato të jenë në gjendje që t'u përgjigjen kërkesave për të dhëna të zbrëthyer sipas seksit dhe moshës. Këto të dhëna duhet të përdoren nga qeveritë kombëtare në formulimin e indikatorëve statistikorë me ndjeshmëri gjinore për monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të politikave dhe të programeve, si dhe për kryerjen e hulumtimeve të rregullta strategjike;

(b) Arritja me pjesëmarrjen e plotë të të gjitha vendeve i një konsensusi ndërkombëtar për indikatorët dhe rrugët për të matur dhunën kundër grave, dhe për të konsideruar krijimin e një baze të dhënash mbi statistikën, legjisllacionin, trajnimin, praktikën më të mira, mësimet e nxjerra, dhe burime të tjera në lidhje me të gjitha format e dhunës kundër grave, përfshirë gratë që migrojnë për punë;

(c) Në partneritet me institucionet përkatëse, të nxitet, të përmirësohet, sistemohet dhe financohet mbledhja e të dhënave të zbërthyer sipas seksit, moshës dhe faktorëve të tjerë, mbi shëndetin dhe qasjen në shërbimet shëndetësore, përfshirë informacionin gjithëpërfshirës të ndikimit të HIV/AIDS mbi gratë, gjatë tërë jetës së tyre;

(d) Të zhduket anshmëria gjinore në kërkimet bio-mjekësore, klinike dhe sociale përfshirë provat klinike vullnetare që përfshijnë gratë, duke marrë në konsideratë të drejtat e tyre njerëzore, dhe konform standardeve ndërkombëtare ligjore, etike, mjekësore, shkencore dhe të sigurisë dhe të mblidhen, të analizohen dhe t'u vihen në dispozicion institucioneve përkatëse dhe përdoruesve të informacionit gjinor, për dozën, efektet anësore efektshmërinë e ilaçeve, përfshirë kontrceptivët dhe metodat që mbrojnë kundër infeksioneve seksualisht të transmetueshme.

93. (a) Ngritja e kapaciteteve të universiteteve, institucioneve kërkimore kombëtare dhe trajnimit dhe institucioneve të tjera kërkimore për të kryer kërkime që lidhen me gjininë dhe politikat në mënyrë që të informohen politikë-bërësit dhe të nxitet zbatimi i plotë i Platformës për Veprim dhe vazhdimësia e saj;

(b) Krijimi i një programi bashkëpunimi Jug-Jug me qëllim ndërtimin e kapaciteteve të makinerive kombëtare për gratë përmes, shkëmbimit të ekspertizës, përvojave dhe dijeve të makinerive kombëtare për fuqizimin e grave, çështjeve gjinore, dhe metodologjive për përfshirjen e perspektivës gjinore dhe taktikat për dymbëdhjetë fushat shqetësuese të Platformës për Veprim;

(c) Mbështetje për qeveritë, në përpjekjet e tyre për të institucionalizuar programet dhe masat që orientohen nga veprimi për përshpejtimin e zbatimit të plotë të Platformës për Veprim, me afate kohore dhe qëllime të matshme dhe metoda vlerësimi, përfshirë vlerësimin e ndikimit gjinor, me pjesëmarrjen e plotë të grave për matjen dhe analizimin e përparimit të bërë;

(d) Të bëhet mbledhja e të dhënave dhe puna studimore në lidhje me gratë indigjene, me pjesëmarrjen e tyre të plotë, në mënyrë që të forcohen politikat, programet dhe shërbimet e hapura, dhe të përshatshme nga pikëpamja kulturore dhe gjuhësore;

(e) Të vazhdohet puna kërkimore për të gjitha tendencat që mund të krijojnë pabarazi të reja gjinore në mënyrë që të krijohet baza për veprim politik.

94. (a) Të merren masa për hartimin dhe zbatimin e programeve me ndjeshmëri gjinore që synojnë nxitjen e ndërmarrjeve dhe të nismave private të grave, dhe ndihmojnë bizneset që janë pronë e grave në pjesëmarrjen dhe përfitimin nga tregtia ndërkombëtare, zbulimet teknologjike dhe investimet;

(b) Të respektohen, mbështeten dhe realizohen parimet e Deklaratës së Organizatës Botërore të Punës për të Drejtat Themelore të Punës¹⁴ dhe të konsiderohet ratifikimi dhe zbatimi i plotë i

¹⁴ Adoptuar në 18 qershor 1998 nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës në sesionin e vet të tetëdhjetë e gjashtë.

konventave të organizatës botërore të punës që janë veçanërisht të rëndësishme për garantimin e të drejtave të grave në punë;

(c) Të inkurajohet dhe të forcohen institucionet ekzistuese të mikrokreditit dhe kapacitetet e tyre, përmes edhe mbështetjes së institucioneve financiare ndërkombëtare, në mënyrë që shërbimet e kreditit për vetë-punësimin dhe aktivitetet që sjellin të ardhura t'u vihen në dispozicion një numri më të madh njerëzish që jetojnë në varfëri, në veçanti grave, për të zhvilluar më tej kur është e mundshme, instrumente të tjera të mikrofinancimit;

(d) Të riafirmohet angazhimi për zhvillimin me ndjeshmëri gjinore dhe mbështetja për rolin e grave në konsumimin e qëndrueshëm dhe ekologjik dhe në modelet e prodhimit dhe të manaxhimit të burimeve natyrore;

(e) Të adoptohen masa për të garantuar njohjen dhe vlerësimin e punës së grave të fshatit, që vazhdojnë të luajnë një rol jetik për sigurimin e ushqimit dhe ushqyerjen dhe që janë të angazhuara në prodhimin bujqësor dhe ndërmarrjet e peshkimit, dhe në manaxhimin e burimeve dhe punës në shtëpi, veçanërisht në sektorin jo zyrtar të ekonomisë. Njohja e kontributit të tyre synon zgjerimin e sigurisë së tyre ekonomike, qasjen e tyre në burimet dhe skemat e kreditimit, shërbimet dhe përfitimet dhe fuqizimin e tyre.

95. (a) të inkurajohen dhe zbatohen ndryshime në kurrikulat për trajnimin e zyrtarëve publikë për t'i bërë atë plotësisht të ndjeshëm ndaj çshtjes gjinore;

(b) të forcohen dhe çohen përpara programet në mbështetje të pjesëmarrjes së të rejave në organizatat e të rinjve dhe të inkurajohet dialogu ndërmjet të rinjve dhe ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe të pazhvilluara;

(c) Të mbështeten përpjekjet kombëtare për edukimin zyrtar dhe jo zyrtar dhe për programe që instruktojnë gratë dhe vajzat për t'i aftësuar ato që të fitojnë dije, të rrisin vetë-vlerësimin dhe shprehitë e udhëheqjes, të përfaqësimit dhe të zgjidhjes së konfliktit;

(d) Të merren veprime të gjithanshme për të ofruar trajnime për të rritur shprehitë e grave dhe të vajzave në të gjitha nivelet në mënyrë që të çrrënjoset varfëria, në veçanti feminizimi i varfërisë, përmes përpjekjeve kombëtare dhe ndërkombëtare;

(e) Të krijohen dhe të zbatohen programe edukative dhe trajnimi me pjesëmarrjen e grave indigjene, që respektojnë historinë, kulturën, spiritualitetin, gjuhët, dhe aspiratat e tyre dhe garantojnë aksesin në të gjitha nivelet e shkollimit zyrtar dhe jozyrtar, përfshirë edhe arsimin e lartë;

(f) të vazhdohet mbështetja dhe të forcohen programet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për zhdukjen e analfabetizmit të të rriturve me bashkëpunimin ndërkombëtar në mënyrë që të arrihet një përmirësim me 50 për qind në nivelet e të rinjve që dinë të lexojnë deri në 2015, veçanërisht për gratë, dhe qasje e barabartë në shkollimin bazë dhe të vazhdueshëm për të rritur;

(g) Të vazhdojë ekzaminimi i rënies së numrit të të regjistruarve në shkollë dhe numri në rritje i vajzave dhe i djemve që lënë shkollën fillore dhe tetëvjeçare në disa vende. Përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, të hartohen programet e duhura kombëtare për eliminimin e këtyre shkaqeve dhe të mbështetet të mësuarit gjatë tërë jetës për gratë dhe vajzat me qëllim garantimin e arritjes së objektivave ndërkombëtare për arsimin të caktuara nga konferencat ndërkombëtare përkatëse;

(h) Të garantohen shanse të barabarta për gratë dhe vajzat në aktivitetet kulturore, argëtuese dhe sportive, si dhe pjesëmarrja në atletikë dhe aktivitetet fizike në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe qasja e barabartë në trajnim, konkurrim dhe çmime;

(i) Të vazhdojnë përpjekjet për të rritur respektin ndaj diversitetit kulturor dhe dialogut ndërmjet civilizimeve si dhe brenda të njëjtit civilizim në mënyrë që të kontribuohet për zbatimin e Platformës për Veprim, që synon në fuqizimin e grave dhe realizimin e plotë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjitha gratë;

(j) Marrja e masave pozitive për t'iu dhënë të gjitha grave, veçanërisht atyre indigjene, qasje të barabartë në programet për rritjen e kapaciteteve dhe në ato të trajnimit për të zgjeruar pjesëmarrjen e tyre në vendim-marrje në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet.

96. (a) Të rritet bashkëpunimi, përgjigja e politikës, zbatimi efektiv i legjislacionit kombëtar dhe i masave të tjera mbrojtëse dhe parandaluese që synojnë të zhdukin dhunën kundër grave dhe vajzave, veçanërisht të gjitha format e shfrytëzimit seksual si dhe atij ekonomik, përfshirë trafikimin e grave dhe të fëmijëve, vrasjen foshnjore të femrave, krimet për nder, krimet për passion, krimet raciale, rrëmbimin dhe shitjen e fëmijëve, dhunën dhe vdekjet që lidhen me pajën, sulmet me acid dhe praktikatat e dëmshme tradicionale ose zakonore, si gjymtimi gjenital femëror, martesat e hershme dhe të detyruara;

(b) Rritja e ndërgjegjësimit dhe e njohurive për Statutin e Romës të Gjykatës Kriminale Ndërkombëtare, që afirmon se përdhunimi, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e detyruar, sterilizimi i detyruar dhe forma të tjera të dhunës seksuale përbëjnë krime lufte dhe në rrethana të caktuara, krime kundër njerëzimit; të marrë masat për të mbështetur ndjekjen penale të të gjithë personave përgjegjës për këto krime dhe të krijohen mundësi për të shpërguar viktimat; edhe për të ngritur ndërgjegjësimin deri në ç' masë këto krime përdoren si armë lufte;

(c) Të mbështesë, në bashkëpunim me sistemin e Kombeve të Bashkuara, përmes bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, organizatat jo-qeveritare, përfshirë organizatat e grave dhe grupet komunitare, në trajtimin e të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe vajzave, përfshirë programet për të luftuar dhunën me bazë racore dhe etnike kundër grave dhe vajzave;

(d) Të inkurajohen fushatat publike për rritjen e ndërgjegjësimit për koston sociale dhe papranueshmërinë e dhunës kundër grave, dhe për organizimin e aktiviteteve parandaluese për të nxitur marrëdhënie të shëndetshme dhe të balancuara bazuar në barazinë gjinore.

97. (a) Të intensifikohet bashkëpunimi midis Shteteve të origjinës, tranzitit dhe destinacionit për të parandaluar, shtypur dhe ndëshkuar trafikimin e personave, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve;

(b) Të mbështeten bisedimet për projekt-protokollin për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të njerëzve, veçanërisht të grave dhe të vajzave, për të plotësuar projekt Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar¹⁵;

(c) Të ndiqen dhe të mbështeten strategji kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për të pakësuar rrezikun për gratë dhe vajzat, përfshirë ato refugjate dhe të zhvendosura si dhe gratë migrante, që të kthehen në viktima të trafikimit; të forcohet legjislacioni kombëtar përmes përkufizimit të krimit të trafikimit në të gjithë elementët e tij dhe duke forcuar ndëshkimin sipas rastit; të hyjnë në fuqi politika sociale dhe ekonomike si dhe nisma informuese dhe ndërgjegjësuere për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e personave, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve; të ndiqen penalisht autorët e trafikimit, të merren masa për të mbështetur, ndihmuar dhe mbrojtur personat e trafikuar në vendet e tyre të origjinës dhe në ato të destinacionit; të lehtësohet rikthimi i tyre dhe riintegrimi në vendet e tyre të origjinës.

98. (a) Të përmirësohen njohuritë dhe ndërgjegjësimi për masat shpagueuse për gratë të cilat u janë dhunuar të drejtat e njeriut;

(b) Të mbrohen të drejtat e njeriut dhe të zbatohen politika për të trajtuar nevojat specifike për të gjitha gratë migruese; të trajtohen pabarazitë ekzistuese ndërmjet burrave dhe grave për të siguruar barazinë gjinore;

(c) Të nxitet respekti për të drejtat e grave dhe të burrave për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit. Të njihet roli qëndror që luajnë feja, spiritualiteti dhe besimi në jetët e miliona grave dhe burrave;

(d) Të inkurajohet përmes mediave dhe mjeteve të tjera të informimit, ndërgjegjësimi më i lartë për efektet e dëmshme të disa praktikave tradicionale ose zakonore që ndikojnë mbi shëndetin e grave, madje duke i rrezikuar ato më shumë ndaj HIV/AIDS dhe infeksioneve të tjera seksualisht të transmetueshme, dhe të intensifikohen përpjekjet për t'i zhdukur këto praktika;

(e) Të merren masat e nevojshme për të mbrojtur individët, grupet dhe organet e shoqërisë të përfshira në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave;

(f) Të inkurajohen Shtetet palë që të vazhdojnë të përfshijnë perspektivën gjinore në raportet e tyre që i dorëzojnë tek organet e traktatit; të inkurajohen këto organe që të vazhdojnë të marrin në konsideratë një perspektivë gjinore për zbatimin e mandateve të tyre, duke konsideruar nevojën për të evituar duplikimin dhe përsëritjet e panevojshme të punës; dhe të inkurajohen mekanizmat e të drejtave të njeriut për të vazhduar që të përfshijnë perspektivën gjinore në punën e tyre;

¹⁵ Shih Rezolutën 54/126

(g) Të mbështeten programe novatore për të fuqizuar gratë e moshuara për të rritur kontributin e tyre dhe për të përfituar nga zhvillimi dhe përpjekjet për të luftuar varfërinë.

99. (a) Të mbështeten programe edukuese për të drejtat e njeriut, në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe të të drejtave të njeriut, aktorët përkatës dhe shoqërinë civile, në veçanti organizatat jo-qeveritare dhe rrjetet e mediave, për të garantuar shpërndarjen e informacionit mbi instrumentet e të drejtave të njeriut, në veçanti ato që lidhen me të drejtat e grave dhe të vajzave;

(b) Të merren masa, përmes forcimit të mekanizmave ekzistues, që janë besuar me ndjekjen penale të autorëve të shkeljeve të të drejtave të njeriut të grave, për ndëshkimin e autorëve;

(c) Të merren masa për të zhdukur shkeljet e ligjit ndërkombëtar dhe të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Shumë nga këto shkelje kanë një ndikim negative mbi të drejtat e njeriut të grave;

(d) Të trajtohen në mënyrë të plotë dhe të fortë shkaqet që qëndrojnë në themel të konfliktit të armatosur si dhe ndikimet e ndryshme të tij mbi burrat dhe gratë, dhe të shihet mundësia për politika dhe programe për të forcuar mbrojtjen e civilëve, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve;

(e) Të garantohet lirimi i pengjeve dhe i të burgosurve veçanërisht i grave dhe i fëmijëve, në konfliktet e armatosur;

(f) Të hartohen dhe mbështeten politika dhe programe për mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht të vajzave, për të penguar rekrutimin e tyre me forcë dhe përdorimin e tyre nga të gjitha aktorët. Të forcohen mekanizmat për riaftësimin dhe ri-integrimin e tyre, duke pasur në konsideratë përvojat dhe nevojat e vajzave;

(g) Të përmirësohet dhe forcohet kapaciteti i grave të ndikuara nga konflikti i armatosur, përfshirë gratë refugjate dhe ato të zhvendosura, duke i përfshirë ato në hartimin dhe manaxhimin e aktiviteteve humanitare që ato të përfitojnë nga këto aktivitete në mënyrë të barabartë me burrat;

(h) Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara, dhe organizatat e tjera humanitare si dhe Qeveritë ftohen që brenda mandateve të tyre respektive të vazhdojnë të mbështesin vendet që kanë numër të madh refugjatësh dhe personash të zhvendosur, në përpjekjet e tyre për mbrojtje dhe ndihmë, duke i kushtuar vëmendje të posaçme nevojave të grave dhe fëmijëve refugjatë dhe të zhvendosur;

(i) Të kërkohet pjesëmarrja e barabartë e grave në promovimin e paqes, në veçanti përmes zbatimit të plotë të Deklaratës dhe Programit për Veprim mbi Kulturën për Paqe¹⁶;

(j) Të mbështeten dhe të fuqizohen gratë që luajnë një rol të rëndësishëm për familjet e tyre si faktorë stabilizues në situata konflikti dhe pas konflikti;

¹⁶ Rezoluta 53/243 A dhe B

(k) Të forcohen përpjekjet për çarmatimin e plotë dhe të përgjithshëm nën kontrollin e rreptë dhe efektiv ndërkombëtar, bazuar në prioritetet e vendosura nga Kombet e Bashkuara në fushën e çarmatimit, në mënyrë që të burimet e fituara të përdoren, për programe sociale dhe ekonomike në të mirë të grave dhe vajzave;

(l) Të eksplorohej rrugë të reja për gjenerimin e burimeve të reja publike dhe private financiare, përmes pakësimit të shpenzimeve të tepruara ushtarake, dhe tregtisë së armësve dhe të investimeve për prodhimin dhe blerjen e armëve përfshirë shpenzimet globale ushtarake, duke marrë në konsideratë kërkesat e sigurisë kombëtare, në mënyrë që të lejohet caktimi i fondeve shtesë për zhvillimin social dhe ekonomik, për përparimin e grave;

(m) Të merren masat për të garantuar mbrojtjen e refugjatëve, veçanërisht të grave dhe vajzave, dhe qasjes së tyre në shërbimet sociale me orientim gjinor, përfshirë arsimin dhe shëndetësinë.

100. (a) Të bashkëpunohet dhe të punohet me partnerët e sektorit privat dhe rrjetet mediatike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të promovuar qasje të barabartë të grave dhe burrave si prodhues dhe konsumatorë, veçanërisht në fushën e informacionit dhe të teknologjisë së komunikimit. Të inkurajohen media dhe industria e informacionit që në përputhje me lirinë e shprehjes të adoptojnë, të përsosin më tej kodet e sjelljes, udhëzuesit profesionalë dhe udhëzues të tjerë vetë-rregullues për të hequr stereotipet gjinore dhe për të nxitur portretizimin e balancuar të grave dhe të burrave;

(b) Të hartohen programe për ngritjen dhe zhvillimin e rrjeteve të grave, në veçanti përmes përdorimit të teknologjisë së re të informacionit dhe të komunikimit, përfshirë përmes programeve që ndërtojnë kapacitetin e organizatave jo-qeveritare të grave;

(c) Të shfrytëzohen teknologjitë e reja të informacionit, përfshirë interneti, për të përmirësuar shkëmbimin global të informacionit, të rezultateve të punës këkimore, pikave të forta, mësimëve të nxjerra nga përvoja e grave, përfshirë “Historitë e Saj”¹⁷ që synon arritjen e barazisë gjinore, zhvillimit, paqes dhe studimit të roleve të tjera që këto teknologji mund të luajnë për arritjen e këtij synimi.

101. (a) Të merren masa efektive për të trajtuar sfidat e globalizimit, përmes pjesëmarrjes efektive të vendeve në zhvillim në procesin e politikëbërjes ekonomike ndërkombëtare, në mënyrë që të garantohet pjesëmarrja e barabartë e grave, në veçanti e atyre nga vendet në zhvillim, në procesin e vendimmarrjes makroekonomike;

(b) Të merren masat, me pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të grave, për të garantuar rrugë të reja të bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim, bazuar në stabilitetin, rritjen dhe barazinë, me pjesëmarrjen efektive të vendeve në zhvillim në globalizimin e ekonomisë botërore, që synon çrrënjësien e varfërisë dhe reduktimin e pabarazisë me bazë gjinore në kuadrin e përgjithshëm për zhvillim të qëndrueshëm që ka në qëndër njeriun;

¹⁷ “Historitë e saj” është një term i përdorur gjërësisht për të treguar përsëritjen e ngjarjeve, historike dhe bashkëkohore, nga këndvështrimi i gruas.

(c) Hartimi dhe forcimi i strategjive për çrrënjosjen e varfërisë, me pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të grave, që pakëson feminizimin e varfërisë dhe zgjeron kapacitetin e grave për të përballur ndikimet negative social-ekonomike të globalizimit;

(d) Intensifikimi i përpjekjeve për të zbatuar programet për çrrënjosjen e varfërisë, dhe vlerësimi me pjesëmarrjen e grave, sesa kanë ndikuar këto programe në fuqizimin e grave që jetojnë në varfëri, sa i takon qasjes së tyre në trajnim dhe arsim cilësor si dhe në kujdesin shëndetësor fizik dhe mendor, në punësim, shërbime sociale bazë, trashëgimi dhe qasje dhe kontroll mbi tokën, strehën, të ardhurat, mikrokreditin, instrumente dhe shërbime të tjera financiare, si dhe përmirësimi i këtyre programeve nën dritën e vlerësimit të mësipërm;

(e) Njohja e lidhjes ndërmjet barazisë gjinore dhe çrrënjosjes së varfërisë, përpunimi dhe zbatimi, në konsultë me shoqërinë civile, i strategjive me orientim gjinor për çrrënjosjen e varfërisë, duke trajtuar çështje sociale, strukturore dhe makroekonomike;

(f) Inkurajimi i hapjes, në bashkëpunim me institucionet private financiare, kur është e përshtatshme i “sporteleve për huadhënie” dhe i shërbimeve të tjera financiare të hapura për të gjitha dhe me procedura të thjeshtuara që janë hartuar posaçërisht për plotësuar nevojat për kursim, kredi dhe sigurim të të gjitha grave;

(g) të merren veprime tërësore për trajnime cilësore të shprehive të punës, për gratë dhe vajzat në të gjitha nivelet, në bazë të strategjive të zhvilluara me pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive, për të arritur targetin për çrrënjosjen e varfërisë, në veçanti të feminizimit të varfërisë, përmes përpjekjeve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Përpjekjet kombëtare duhen të plotësohen edhe nga bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në mënyrë që të trajtohen rreziqet, të kapërcehen sfidat dhe të garantohet që nga shanset e krijuara nga globalizimi të përfitojnë edhe gratë, veçanërisht ato në vendet në zhvillim

(h) Të krijohet fondi për zhvillimin social, me pjesëmarrjen efektive të grave dhe në konsultim me shoqërinë civile, veçanërisht me organizatat jo-qeveritare, për të lehtësuar efektet negative që vijnë nga programet e ndryshimeve strukturore, nga liberalizimi i tregtisë dhe barra e pabarabartë e mbajtur nga gratë që jetojnë në varfëri;

(i) Të identifikohen dhe zbatohen zgjidhje të qëndrueshme për zhvillim që integrojnë perspektivën gjinore në borxhin e jashtëm dhe në problemet e shërbimit të borxhit të vendeve në zhvillim, duke përfshirë edhe vendet më pak të zhvilluara, përmes lehtësimit të borxhit, përfshirë edhe mundësinë për faljen e borxhit të ndihmës zyrtare për zhvillim, në mënyrë që të ndihmohen ata që financojnë programet dhe projektet që synojnë zhvillimin, edhe përparimin e grave;

(j) Të mbështetet nisma e Këlnit për pakësimin e borxhit, veçanërisht zbatimi i shpejtë i Nismës së Borxhit për Vendet e Varfëra të Zhytyra në Borxhe; të garantohet dhënia e fondeve të nevojshme për zbatimin e saj dhe të zbatohet dispozita që fondet e kursyera të kalojnë për programet që trajtojnë dimensionet gjinore;

(k) Të nxitet dhe të përshpejtohet zbatimi i Nismës 20/20, që integron perspektivën gjinore në të mirë të të gjithëve, veçanërisht të grave dhe të vajzave.

(l) Të bëhet thirrje për bashkëpunim ndërkombëtar, përfshirë riafirmimin për arritjen e targetit ende të paarritur që 0.7 për qind e prodhimit kombëtar bruto të vendeve të zhvilluara të shkojë për programet e ndihmës zyrtare për zhvillim, duke rritur kështu fluksin e burimeve për barazi gjinore, zhvillim dhe paqe;

(m) Të lehtësohet transferimi në vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicion i teknologjisë së përshtatshme, veçanërisht teknologjisë së re dhe moderne, dhe të inkurajohen përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për eliminimin e pengesave për këto transferata, si një mjet efektiv për të plotësuar përpjekjet kombëtare për përshpejtimin e arritjes së barazisë gjinore, zhvillimit dhe paqes;

(n) Rekomandohet që Komiteti Përgatitor për Asamblenë e Mileniumit të përpiqet që brenda kontekstit të përfshirjes së perspektivës gjinore në sistemin e Kombeve të Bashkuara, të integrojë perspektivën gjinore në të gjitha aktivitetet dhe dokumentet që lidhen me Asamblenë dhe Samitin e Mileniumit, përfshirë edhe çrënjësosjen e varfërisë;

(o) Të krijohet një mjedis lehtësues dhe të hartohen dhe zbatohen politika për mbrojtjen e të drejtave të njeriut – civile, kulturore, ekonomike, politike, dhe shoqërore, përfshirë të drejtën për zhvillim dhe liritë themelore si pjesë e përpjekjeve për të arritur barazi gjinore, zhvillim dhe paqe.

102. (a) Të krijohet dhe forcohet mjedis lehtësues, në përputhje me ligjet kombëtare, për të mbështetur organizatat jo-qeveritare të grave për të garantuar qëndrueshmërinë e aktiviteteve të tyre;

(b) Të inkurajohet ngritja dhe forcimi i partneritetit/bashkëpunimit të palëve të shumta të interesit në të gjitha nivelet ndërmjet organizatave ndërkombëtare dhe ndër-qeveritare, me aktorët përkatës dhe shoqërinë civile, me organizatat jo qeveritare, sektorin privat dhe sindikatat, organizatat e grave dhe organizatat e tjera jo qeveritare, sistemet e komunikimit dhe të medias në mbështetje të qëllimeve të Konferencës së Katërt Botërore të Grave;

c) Të inkurajohet partneriteti dhe bashkëpunimi ndërmjet qeverive, organizatave ndërkombëtare, në veçanti institucioneve financiare ndërkombëtare dhe organizatave multilaterale, sektorit privat dhe shoqërisë civile, përfshirë organizatat jo qeveritare, veçanërisht organizatat e grave dhe atyre komunitare, për të mbështetur nismat e çrënjësosjes së varfërisë me fokus gratë dhe vajzat;

(d) Të njihet roli vendimtar i grave, i organizatave joqeveritare të grave dhe i organizatave me bazë komunitetin për zbatimin e Axhendës 21¹⁸, përmes integritit të perspektivës gjinore në

¹⁸ Raporti i Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin, Rio de Janeiro, 3-14 qershor 1992 (Publikimi i Kombeve të Bashkuara, Shitjet Nr. E.93.I.8 dhe ndreqjet gabimesh), vol. I, Resolutat e adoptuar nga Konferenca, rezoluta 1, aneksi II.

formulimin, hartimin dhe zbatimin e mekanizmave për manaxhimin e qëndrueshëm, mjedisor dhe të burimeve, programeve dhe infrastrukturës.

103. (a) Të promovohen programe për moshimin e shëndetshëm, aktiv që thekson pavarësinë, barazinë, pjesëmarrjen dhe sigurinë për gratë e moshuara dhe ndërmerr kërkime specifike gjinore, dhe programe që trajtojnë nevojat e tyre;

(b) çështje me përparësi, veçanërisht në vendet e ndikuara, dhe në partneritet me organizatat jo-qeveritare, të intensifikohet arsimimi, shërbimet dhe strategjitë për mobilizimin me bazë komunitetin për të ruajtur gratë e të gjitha moshave nga HIV dhe infeksione të tjera seksualisht të transmetueshme, përfshirë përmes metodave femërore të sigurta, të përballueshme, efektive, dhe të gjatshme, përfshirë metodat si mikrobicidet dhe prezervativët femërorë që të mbrojnë nga infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS; testimi dhe këshillimi vullnetar për HIV; promovimi i sjelljeve të përgjegjshme seksuale; përfshirë abstinencën dhe përdorimin e prezervativit; zhvillimi i vaksinave, diagnostikimi me kosto të ulët dhe trajtimi me një dozë të vetme për infeksionet seksualisht të transmetueshme;

(c) Ofrimi i trajtimit të përshtatshëm dhe të përballueshëm, monitorimi dhe kujdesi për të gjithë njerëzit, veçanërisht për gratë dhe vajzat, e infektuara me infeksione seksualisht të transmetueshme ose që jetojnë me sëmundje të rrezikshme, përfshirë HIV/AIDS dhe sëmundjet oportuniste që i shoqërojnë ato, si tuberkulozi. Dhënia e shërbimeve të tjera, përfshirë strehimin dhe mbrojtjen sociale, shtatzëninë dhe ushqyerjen me gji; ndihma për vajzat dhe djemtë jetimë si rezultat i HIV/AIDS; ofrimi i sistemeve me orientim gjinor për gratë dhe anëtarët e familjes që kujdesen për personat me sëmundje të rënda, përfshirë HIV/AIDS;

(d) Marrja e masave të shpejta, efektive për të mobilizuar opinionin publik kombëtar dhe ndërkombëtar në lidhje me efektet e problemit botëror me drogën për gratë dhe vajzat dhe garantimi i burimeve të nevojshme për to.

104. Të inkurajohen partneritetet ndërmjet qeverive dhe organizatave jo-qeveritare për zbatimin e angazhimeve të bëra në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë dhe në konferenca dhe samite të tjera botërore të Kombeve të Bashkuara, me qëllim promovimi i barazisë gjinore, zhvillimit dhe paqes në shekullin e njëzetë e një.